



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

Procesverbal

Nga Seanca e shtatë (VII) të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, mbajtur më datë 29.9.2015 me këtë:

REND PUNE

- 1 Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar
- 2 **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 2.1. Betimi i anëtarëve të rinj të Kuvendit,
 - 2.2. Iniciativë për shpalljen “Qytetare Nderi” e znj.Hanife Malaj,
 - 2.3. Propozim Buxheti për vitin fiskal 2016
 - 2.4. Propozim vendimi për caktimin e përbërjes së Komitetit konsultativ të ekspertëve të planifikimit hapësinor,
 - 2.5. Draft Rregullorja për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin fiskal 2016
 - 2.6. Raporti i Komisionit të aksionarëve për gjendjen në Ndërmarrjen Publike “Eko Higjiena”, Gjilan
 - 2.7. Raporti i Komisionit të aksionarëve për gjendjen në Ndërmarrjen Publike “Stacioni i Autobusëve”, Gjilan
 - 2.8. Propozim projekti për kompensimin e Komisionit për plotësimin e emërimit të rrugëve dhe numrimit të adresave për teritorin e Komunës së Gjilanit
 - 2.9. Raporti i Korrije shirjeve 2015
 - 2.10. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Gjilanit për vitin e përfunduar më 31.12.2014
- 3 Të ndryshme

Në punimet e seancës së VII (shtatë) morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit

Zv/kryetari i Komunës, z. Rexhep Kadriu

Drejtorët e drejtorive

Përfaqësuesja i OSB-së, Sadete Ternava

Përfaqësuesi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, z. Fazli Abdullahu

Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile, z. Shaban Terziu

Përfaqësuesi i Aksionarëve të Stacionit të Autobusve, Abdyl Jerliu

Përfaqësuesi i Aksionarëve të Kompanisë Publike “Eco- Higjierna”, Muhadin Haziri

Mediet

Seancën e shtatë (VII) e hapi dhe udhëhoqi, kryesuesja e Kuvendit, zonja Valentinë Bunjaku-Rexhepi e cila i përshëndeti anëtarët e Kuvendit dhe të gjithë të pranishmit e tjerë të cilët i monitorojnë punimet e seancës dhe kërkoi që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në punimet e kësaj seance.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në punimet e seancës së shtatë ishin të pranishëm 33 anëtarë, kurse munguan: Nevzad Isufi dhe Jashar Jashari i cili mungonte me arsyeje.

Në fillim të punimeve të seancës kryesuesja theksoi fillimisht e kemi një kërkesë nga DEMOS-it , sepse do të organizohet një trajnim për financat lokale për të gjithë anëtarët e Kuvendit, në të cilin trajnim do të përfshihen 17 komuna, jo partnere të DEMOS-it, sepse të tjerat komuna e kanë përcjell këtë trajnim. Trajnimi do të mbahet brenda territorit të Kosovës i cili do të zgjat tri ditë i cili mund të mbahet në Hotelin “Dukagjin”, Brod dhe Bogaj, varësisht se ku ju përcaktoheni.

Ju duhet të vendosni se ky trajnim a dëshironi të mbahet gjatë ditëve të vikendit apo gjatë ditëve të punës, por edhe duhet të përcaktoheni se ku dëshironi të mbahet?

Me 19 vota për anëtarët e Kuvendit u pajtuan që ky trajnim të mbahet ditëve të punës, kurse për ditë vikendi ishin 2 vota. Gjithashtu u mor vendim që trajnimi të mbahet javën e dytë të muajit tetor, në Brod.

Si çështje e dytë kryesuesja theksoi se në rend të punës duhet të hyjë edhe një pikë e cila është një Letër mbështetëse për kryetarin e Komunës i cili kërkon që t’ i epet mandati si përfaqësues ligjor për të nënshkruar Konventën e Kryetarëve duke pasur parasysh të gjitha angazhimet, të cilat angazhime janë të renditura në këtë letër mbështetëse e cila iu shpërnda anëtarëve të Kuvendit.

Kryesuesja kërkoi që të deklarohen anëtarët e Kuvendit se kush është që jepet mbështetje kryetarit të Komunës?

U aprovua kjo letër mbështetëse e kryetarit të Komunës me 19 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan.

Në vijim kryesuesja e hap debatin përkitazi me rendin e punës?

Sahit Abazi-fillimisht drejtorëve të rinj i urojmë suksese dhe punë të mbarë e të cilët do të ken mbështetje për punët e mira që do t’ i bëjnë dhe të cilat janë të dobishme për qytetarët.

Sa i përket rendit të ditës, ne kemi një plotësim në pikën 2.2. e cila ka të bëjë me shpalljen Qytetar Nderi të Hanife Malaj e që ne jemi 100% që kjo të ndodh, sepse kjo është vetëm një zyrtarizim për arsye se ajo

e ka arrit këtë epitete, sepse tërë Gjilani dhe më gjerë e respektojnë dhe e nderojnë dhe nuk ka asnjë dilemë sa i përket zonjës Hanife.

Mirëpo, mos shpallja e Rexhep Berishës Qytetar Nderi, po aludon se ne po tentojmë për t' i ndarë heronjtë tanë ? Edhe Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha kanë vepruar dha kanë ra së bashku, kurse familjet e tyre së bashku i kanë ndjekur idealet e tyre, duke i motivuar familjet e tjera që të japin të rinj për luftën dhe kauzën tonë kombëtare. Baca Rexhë në çdo mënyrë është nder për qytetin, ecja dhe krenaria dhe plisi i tij na bën edhe neve që të jemi krenar për këtë baba dhe gjysh që e dha të birin për çështje kombëtare. Për këtë arsyeje ne si PDK, kërkojmë që edhe Hanife Malaj dhe Rexhep Berisha të shpallen në të njëjtën ditë, në të njëjtën kohë dhe vend Qytetar Nderi të Komunës së Gjilanit.

Si çështje tjetër të cilën e kemi theksuar edhe në KPF është që në këtë seancë të jetë edhe një kërkim falje nga kryetari i Komunës për një akuzë shumë të rëndë që ia ka bërë PDK-së në Gjilan.

Fillimisht kryetari këtë akuzë ia ka bërë LVV, por brenda ditës e ka ndërruar qëndrimin dhe ka deklaruar se LVV nuk i ka dëmtuar gomat e veturave të Komunës, por e ka thënë kështu: “ po dyshoj se është PDK ose është UDB-ja” ! Ne kemi kërkuar që sot në këtë seancë të jetë edhe komandanti Regjional i Policisë për të na njoftuar se deri ku kanë arrit me hetime për këtë rast.

Ne jemi për atë që çdo kush që e dëmton pasurinë e Komunës të dëmtohet sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, por nëse kryetari këtë deklaratë e ka dhënë për pa menduar mirë, është mirë që të kërkoj falje, sepse ne nuk krahasohemi me UDB-në, sepse me dekada të tëra e kemi luftuar UDB-në. Ne kërkojmë që në seancë e radhës kryetari të jap sqarime dhe të kërkoj falje ose në të kundërtën ne si PDK do ta shqyrtojmë pozicionin tonë, sepse kjo është një akuzë shumë e rëndë që mund ta marrim nga një kryetar.

Gjithashtu ne kemi kërkuar gjatë tërë vitit që të raportohet në Kuvend për ndërtimet pa leje i cili raportim nuk ka ndodhur asnjëherë dhe po e përsërisim këtë kërkesë e që së paku e kemi bërë 10 herë, kurse në ndërkohë ndërtimet në Gjilan janë rritur për 10 herë më shumë.

Kërkojmë një raport të detajuar për Lumin Mirusha, për ta ditur se deri ku kanë arritur punimet?

Ne kemi kërkuar në disa seanca një strategji për punësimin, sepse na kujtohen premtimet elektorale për vende të punës e të cilat nuk po ndodhin!

Po ashtu pas të reshurave të mëdha që pat këtë vit në zonat rurale ka pasur dëmtime të mëdha të rrugëve dhe infrastrukturës e si rast specifik është Vërbica e Zhegocit, sepse transportuesit e nxënësve e kanë problem t' i lëvizin automjetet e tyre për shkak të dëmtimit enormë të rrugës.

Kërkojmë që në këtë rast që të ndërhyhet më shpejtë dhe është e rrugës që Komuna t' iu ndihmojë.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – këto kërkesa i kemi marrë edhe në KPF, por kryetari nuk është i pranishëm në punimet e kësaj seance, sepse babanë e ka në gjendje të rëndë shëndetësore. Sa i përket kërkim faljes, kryetari është njoftuar me këtë kërkesë dhe me siguri se do të jap ndonjë përgjigje. Ndërtimet pa leje në seancën e radhës do të jetë pikë e veçantë e rendit të punës.

Bujar Nevzadi- sa i përket mungesës së kryetarit, unë qysh dje kam deklaruar se kryetari nuk do të marrë pjesë në seancë, sepse e kemi një kryetar të papërgjegjshëm e që kam thënë që nga fillimi i mandatit. Kryetari ka qenë desh të vijë në Kuvend, sepse e kam obligim ligjor që të jetë në seancë kur debatohet për propozim- buxhetin e vitit vijues kalendarik. Kryetari ka qenë desh të vijë në seancë dhe ta thekson me emër dhe mbiemër kush i ka dëmtuar gomat e veturave të Komunës, ose duhet të thotë kam gabuar. Aty janë kamerat 24 orë dhe janë rojtarët 24 orë dhe shumë lehtë mund të dihet se çka ka ndodhur. Kryetari duhet të jap sqarime për fjalën e tij publike dhe duhet ta bëjë, sepse nuk ka ku të shkojë. Me këtë deklaratë kryetari i ka ofenduar 10 mijë qytetarë, anëtarë të PDK-së.

PDK dhe krerët e saj e kanë luftuar UDB-në që nga fillimi dhe është deklaratë shumë e papërgjegjshme e kryetarit kur e ka bërë këtë krahasim.

2. Që nga fillimi kam kërkuar që të jepet një informatë nga DKA për fillimin e viti shkollor, sepse ka kaluar një muaj që ka filluar viti shkollor. Gjendja në arsim në Komunën e Gjilanit është shumë e rëndë, sepse arsimi është politizuar në të gjitha fushat edhe në punësim edhe në regjistrim të nxënësve në

klasë të parë dhe dhjetë, por edhe përgatitjet nuk janë bërë, por gjithashtu ka edhe fshehje të vendeve të punës. Drejtoria i Arsimit e ka gjendjen katastrofale, kurse drejtori e ka marrë komplet stafin dhe kanë shkuar në “zjaret” në Turqi, kurse sa për reklamë janë fotografuar në aeroport.

3. E kemi kërkuar që të futet në rend pune : ndërtimet pa lej dhe iu lus që në seancën e radhës të jetë pikë e rendit të punës.

4. Salla e Kuvendit e cila është duke u rinovuar të cilën nuk e kam parë, por jam informuar se është shumë e ngushtë, por salla ku gjendemi ne është një ndër sallat më të mira në Kosovë.

Nuk ka pasur nevojë të harxhohen para për atë sallë dhe të futemi në atë ngushticë. E kemi sallën shumë të mirë dhe nuk ka pasur nevojë ta ndërrojmë sallën.

5. Kërkoj që të na njoftoni lidhur me punësimin e anëtarëve të familjeve të juaja, sepse ju keni deklaruar se do t’i ndihmojmë të varfëritë dhe të papunët, por ju i keni punësuar familjarët e juaj.

Kërkojmë që të na i sjell emrat e të punësuarve drejtori i Arsimit, por edhe në kompanitë publike, Higjienë dhe Hidromoravë.

Drejtori i Zhvillimit Ekonomik posa është emëruar drejtor ka deklaruar: “ do ta kthejmë besimin e investorëve”? A do të thotë kjo deklaratë se deri kur ka ardhur ky drejtor nuk kanë pasur besim investorët në Qeverinë Komunale? Në fund e falënderojmë shefin e grupit të LDK-së-së i cili e ka liruar hapësirën dhe 50 familje tash kanë rrugë. Pas presionit që kemi bërë ne ky në vend se vetë ta lirojë rrugën, ka pritur ne t’i bëjmë presion.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- pasi që drejtori i Arsimit nuk është i pranishëm në seancë dhe e kam thënë edhe në KPF që nuk do të jetë, prandaj ne nuk kemi pasur mundësi që të raportojmë për gjendjen në arsim për pa qenë drejtori.

Sa i përket varfërisë, unë e di që Komuna e Gjilanit i ka ndërtuar 16 shtëpi dhe 16 familje kanë kulm mbi kokë, kurse në ndërtim e sipër janë edhe 4 të tjera, por do të vazhdohet më këtë tempo edhe më tutje. Unë jam e bindur asnjë qeverisje e kaluar për një mandat nuk i ka ndërtuar 16 shtëpi. Informata për ndërtimet pa leje do të jetë pikë e veçantë e rendit të punës, kurse në pikën nën të ndryshme do të debatojmë për gjendjen në arsim.

Avdyl Aliu – nuk është e njerëzishme të flitet për ata që nuk janë prezent në seancë(për kryetarin dhe drejtorin e Arsimit). Është mirë të rezervohemi, ata do të jenë këtu, ata janë shumë të përgjegjshëm dhe dinë për t’u përgjigj shumë mirë. Ju e dini shumë mirë përgjigjet që do t’i merrni edhe nga kryetari, por edhe drejtori i Arsimit, por nuk është mirë të flitet për ata që nuk janë këtu, prandaj rezervohuni, sepse ata do të jenë këtu.

Sa i përket Arsimit mendoj se nuk kemi se çka të flasim sot dhe arsyeja është vetëm pse mungon drejtori. Drejtori do jetë këtu dhe do ta jep informatën dhe rezervohuni dhe pritni të jetë edhe drejtori këtu ! Për kanalizimin dhe problemin në Zabelin e “Sahit Agës” mua më vjen mirë që po plotësohen kërkesat e qytetarëve të kamotshme. Është mirë që dikujt iu ka kujtuar tash për të më thënë mua dhe të më bëj presion mua për t’i kryer këto punë. Për gjashtë-shtatë vjet me radhë asnjë punë asnjë cent investime në Zabel nuk janë bërë. Për të gjitha ato vite dikujt nuk i ka ra ndërmend për të bërë diçka në atë lagje, kurse tash i ka ra ndërmend të më bëj presion mua, kjo është absurd i llojit të vetë.

Unë një seancë kam dal në foltore dhe kam dëshmuar me dokumente se unë nuk kam penguar asgjë, por tri pronat e mia i kam vu në dispozicion të kompanisë dhe të projektit dhe çdo gjë ka përfunduar si është më së miri. Për këtë arsyeje mendoj se nuk është mirë të kthehem aty ku nuk bën ! Duhet të ketë çdo kush keqardhje për të folur diçka që nuk qëndron, sepse jemi anëtarë të Kuvendit dhe fjala jonë ka peshë!

Isa Agushi- sa i përket pikës 2.2 për shpalljen Qytetar Nderi të zonjës Hanife, po bëhet një ndarje, sepse duhet të jetë i propozuar edhe Rexhep Berisha (të propozohen bllok të dy përnjëherë).

Gjithashtu edhe salla e Kuvendit e cila është në renovim me të vërtetë është shumë e vogël dhe nuk i plotëson kushtet për neve. Kjo sallë ku gjendemi është shumë e mirë dhe është për keqardhje nëse ndërrohet kjo dhe shkojmë diku tjetër.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- propozimin për shpallje Qytetar Nderi për zonjë Hanife është i kryetarit të Komunës dhe kur të vijmë tek kjo pikë do të jap arsyetimin dhe do ta marrim vendimin së bashku. Nuk do të thotë se axha Rexhë nuk do të jetë me një të ardhme, mirëpo duhet të zbatohen disa procedura. Për neve këto familje janë të barabarta, por kësaj radhe është ky emër.

Izmi Zeka- procedurat i dimë të gjithë dhe nuk duhet të na i tregojë askush, sepse ne si PDK për gjashtë vite i kemi zbatuar procedurat. Mirë është bërë që kryetari e ka iniciuar zonjën Hanife për ta shpall Qytetare Nderi, por ato dy familje tërë kohën kanë qenë së bashku dhe Kuvendi mund të vendos për çështje të caktuara. Ju e dini mënyrën se si Ilir Metën e keni shpall Qytetar Nderi pa asnjë procedurë ! Unë nuk po them se Ilir Meta nuk e ka merituar një titull të tillë, por cilat procedura janë zbatuar? Prandaj axha Rexhë është një figurë emblematike e Gjilanit, prandaj për të mos e ndarë Nuhun dhe Rexhepin është mirë që ju bashkërisht t'iu bëjmë nderin e merituar.

Ne i dimë kontributet e tyre, prandaj ne sot është mirë që të dy t' i shpallim Qytetarë Nderi dhe mos të presim edhe dy apo tre muaj. Kuvendi e ka këtë të drejtë dhe besoj fuqishëm se asnjë nga anëtarët e Kuvendit nuk do të jetë kundër. Prandaj zonjën kryesuese e lus që kjo të hap rrugë për ta kaluar këtë propozim, sepse nuk do të jetë asnjë defekt procedural. Nëse duhet të merr dikush përgjegjësi marrim ne si Kuvend. Ne me këtë i bëjmë nder qyteti të Gjilanit, prandaj zonja kryesuese propozoj për votim dhe nëse kalon ne ecim më tutje. Janë dy familje emblematike, janë bashkë dhe për këtë po e bëjmë një propozim të tillë.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- unë e thash arsyetimin dhe më vjen mirë që kryetari i Komunës ka ide të tilla e të cilave ide i bashkëngjiten edhe të tjerët. Mirëpo iniciativa e kryetarit të Komunës është kjo, por herën tjetër ju e jepni propozimin dhe e kalojmë. Pikë e rendit të punës është për shpallje Qytetare Nderi Hanife Malaj dhe nuk ka nevojë për ta politizuar këtë debat. Unë nuk mund ta hedh në votim dhe mandej të votohet ose mos të votohet, sepse axha Rexhep është në figurë e çmueshme për Gjilanin.

Fehmi Sylejmnani - s' do mend se jemi për shpalljen "Qytetar Nderi", znj. Malaj, mirëpo në këtë rast kërkojmë si subjekt politik opozitar, që edhe babai i Nuhi Bersihës, plaku mjekërbardhë Rexhep Berisha të shpallet qytetar nderi. Analizoni dhe gjykoni vetë ju të nderuar kuvendarë, se këta trima, që janë figura më markante për Gjilanin, nuk ka mundur ti ndajë UDB-a, ndërkaq pushteti aktual shtrydhet dhe bënë kalkulime politike, duke selektuar vetëm njërin prej tyre, përkatësisht shpall vetëm njërin familjar Qytetar Nderi. Për të mos u keqkuptuar në asnjë mënyrë me askënd, nuk jemi kundër zonjës Malaj, por kërkojmë me ngulm, sikur që kanë rënë dëshmorë të dy bashkë, të shpallen edhe familjarët e tyre në të njëjtën kohë bashkërisht Qytetar Nderi.

E dyta edhe pse sot mungon drejtori i Arsimit unë mendoj se duhet të raportohet dhe diskutohet, sepse gjendja aktuale në Komunën e Gjilanit në arsim është kaotike. Kurrë më keq nuk ka qenë gjendja se tash që është.

E treta ne shumë pyetje po i bëjmë këtu dhe askush më nuk merret me te, por mbesin vetëm në procesverbal, prandaj Zyra Ligjore apo kush është kompetent duhet t' i merr ato pyetje dhe t' i drejtojë në drejtoritë përkatëse, kurse drejtoritë të na i japin përgjigjet në seancë të radhës apo në adresat tona elektronike. Ne kemi adresuar pyetje edhe gojore edhe me shkrim dhe rrallë marrim përgjigje.

Leonorë Bunjaku- unë vetëm një pyetje do ta parashtroj para anëtarëve të Kuvendit; " si do ta arsyetojnë këtë lëshim para familjes Berisha? Gjithashtu jam thellë e bindur se zonja Malaj nuk do ta pranojë këtë ndarje, sepse asnjëherë nuk ka pasur ndarje në mes tyre!?"

Riad Rashiti- unë kam dy propozime lidhur me rendin e punës. E para është pika 2.3 e cila ka të bëjë me buxhetin dhe pikën 2.10 e që është Raporti i auditorit dhe pika 2.5 të hiqen nga rendi i punës dhe të propozohen për seancën e radhës. Kryetari i Komunës është i obliguar të jetë i pranishëm në seancë kur të aprovohet buxheti për çdo vit fiskal. Mungesa e kryetarit të Komunës është henidikep dhe është jo ligjor nëse aprovohen, pa prezencën e tij, sepse ka ndryshime thelbësore në këto tri pikë.

Unë e shoh të domosdoshme prezencën dhe diskutimin e kryetarit të Komunës kur bëhet fjalë për buxhetin, sepse buxheti ka ndryshim dhe zvogëlim për gjysmë milion €, është rrit tatimi në pronë për 17%, kurse raporti i Auditorit është shumë shqetësues për qeverisjen e Komunës së Gjilanit për vitin 2014. Unë propozoj që këto tri pikë të hiqen nga rendi i punës dhe këto të diskutohen kur kryetari të jetë prezent në seancë.

Shukrie Rapuca- unë e kam një pyetje dhe një shqetësim; e para gjatë ndërtimeve të cilat po ndodhin koha pas kohe dhe konkretisht është fjala për rrugën “Bajram Lloca” nga qyteti në Zabel të “Sahit Agës” ku qe disa herë po bëhen disa riparime, sidomos pranë shtëpisë së kryetarit, por gjatë rregullimit të trotuarit po nxirren drunjtë dekorativ. Kam pyetje pse po nxirren ata drunj dekorativ kur trotuarit mund të ndërtohet edhe për pa i nxjerr drunjtë, sepse ka qenë trotuari dhe ata drunj janë mbjell. Mirëpo nëse mendohet për rimbjellje të paktën duhet të jetë masa e duhur për rimbjellje, por pasi po nxirren ata drunj janë të pavlefshëm për rimbjellje.

Arben Maliqi- u fol shumë në këtë seancë, por për mua është e paqartë pse po ekzistojnë shefat e grupeve, sepse kaloi një orë gati dhe po humbim kohë duke biseduar për gjëra të cilat kanë mundur të zgjidhen më herët. Shefat e grupeve janë ata të cilët i paraqesin propozimet dhe nuk ka kuptim ta merr fjalën secili.

Unë mendoj se për arsimin nuk kemi se çka të bisedojmë edhe pse ka qenë desh të jetë një pikë e rendit të ditës, por pasi nuk është këtu drejtori nuk është e njerëzishme të debatojmë, prandaj kjo pikë duhet të bisedohet në mbledhjen tjetër.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- ne jemi te pikat e rendit të punës dhe propozimi i juaj ishte që Qytetar Nderi të shpallet edhe z. Rexhep Berisha. Unë mendoj se ne si Kuvend kemi të drejtë të marrim vendime dhe për këtë familje edhe pse neve nuk na ka ikur Rexhep Berisha, por e kemi menduar për ndonjë periudhë tjetër ta shpallim axhën Rexhep, por kërkesa e juaj është që të shpallen të dytë zonja Hanife dhe axha Rexhep. Unë po krenohem me këtë pikë dhe në rend të punës së pikës 2.2. ju lus të deklaroheni se kush është që edhe Rexhep Berisha të shpallet qytetar nderi së bashku me Hanife Malajn?

Aprovohet propozim- vendimi që Hanife Malaj dhe Rexhep Berisha të shpallen Qytetar Nderi, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në seancë.

Valentinë Bunjaku -debati për rendin e punës përfundoi, por propozimi i z. Rashiti ishte që të hiqen nga rendi i punës pika 2.3, 2.5 dhe 2.10, ju lus që të deklaroheni se kush është që këto tri pikë të hiqen nga rendi i punës ?

Për propozimin e z. Rashiti votuan 11 anëtarë të Kuvendit, kurse kundër ishin 14 anëtarë.

Valentinë Bunjaku-Rexhepi – kush është për rendin e punës së propozuar, duke ia shtuar pikës 2.2 edhe propozimin për shpallje edhe të një Qytetari Nderi (Rexhep Berisha) ?

Aprovohet ky rend i punës me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit, 6 kundër, kurse 5 ishin abstenime.

Riad Rashiti- po iu a bëj me dije se po vazhdoni për ta shkel Rregulloren e punës dhe Statutin e Komunës, sepse kjo është shkelje ligjore .

Fehni Sylejmani – edhe unë pajtohem plotësisht me z. Rashiti dhe po ia përkujtoj nenin 58 pika nën “I” të LVV-së për përgjegjësitë e kryetarit (të cilin nen e lexon z. Sylejmani). Kjo është shkelje ligjore për të gjithë ata që votuan.

Procesverbali u miratua pa vëreje

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa

2.1. Betimi i anëtarëve të rinj të Kuvendit Komunal

Betimin si anëtar i ri Kuvendit të Komunës e jep z. Refik Shala, i cili e zëvendëson Zijadin Maliqin, sepse z. Maliqi është emëruar drejtor për Buxhet dhe Financa.

2.2. Iniciativë për shpalljen Qytetar Nderi, znj. Hanife Malaj

Avdyl Aliu- është bërë një punë e mirë, sepse u plotësua edhe me Rexhep Berishën , por dikush tash paksa gjetur dashuri për Rezhep Malën dhe Nuhi Berishën. Ka qenë rasti edhe më herët, sepse këto punë kanë pasur mundësi të kryhen edhe më herët. Unë e admiroj kryetari dhe politikën e tij që po bën në këtë aspekt dhe në këtë drejtim duke filluar nga projekti i Varrezave të Dëshmorëve, me emërtimet të shkollave dhe institucioneve tjera dhe po e them se me shumë respekt Shkolla e Zabelit e mban emrin e Zija Shemsiut , kurse Shkolla në Lagjen e dytë emrin e Nazmi Hoxhës. Ne në emër të grupit të LDK-së e përkrahim këtë iniciativë.

Sahit Abazi- z. Avdyl stilin e komunikimit e ka të tillë, sepse na nxit për polemika, prandaj kryetari është mirë t’ i zbatojë ato çka ia ka premtuar njerëzve, kryetari ka qenë deshtë ta përfundojë projektin e Varrezave të Dëshmorëve dhe kryetari duhet më shumë të kujdeset për bustet e heronjve. Unë përtej kësaj që po shpallim qytetarë nderi, duke dëshiruar që kryetari të mos ketë hile politike për asnjë prej rasteve, ne duhet të jemi shumë më shumë karshi kërkesave të ligjshme që i kanë edhe Shoqatat e Dala nga Lufta edhe Familjeve të Dëshmorëve dhe të jemi më të kujdesshëm për mirëmbajtje të busteve, shtatoreve dhe shesheve të Dëshmorëve.

Ne e kemi diskutuar në PDK dhe jemi të entuziazmuar që të shpallim Qytetar Nderi Hanife Malajn së bashku me bacën Rexhë.

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- më vjen keq dhe nuk desha ta politizoj këtë rast, por pasi më detyruat po iu them se për 6 vjet në qeverisjen e juaj nuk keni pasur ide për ta shpall qytetar nderi, kurse tash po bëni propozime për një familje që ka qenë ideja e kryetarit të Komunës. Duhet t’ i falënderoni anëtarët e LDK-së që po e mbështesin idenë e juaj, sepse pa numra nuk kalon asnjë propozim. Mos të bëjmë politikë me familje të Dëshmorëve dhe unë e uroj këtë propozim dhe jam e lumtur që dy familjeve po i shpallim nga një anëtarë Qytetar Nderi. Faleminderit pozitivë dhe opozitivë

Fehmi Sylejmani-kjo pikë u debatua gjatë, por mbretëroi logjika e arsyes dhe jemi të gjithë në dakord që këta dy personalitete përkatësisht familje të shpallen Qytetar Nderi. Ne Gjilani mburremi me këta dy heronj të mëdhenj.

Selami Xhemajli- ne iniciativën e kryetari për shpalljen e Hanife Malajt për shpallje Qytetare Nderi e kemi mbështet pa dallim në KPF, mirëpo kjo temë nuk ka qenë deshtë të politizohet ashtu siç pat tendenca dhe jam kundër politizimit. Rexhepi dhe Nuhiu kanë veprua bashkë dhe kanë rënë bashkë dhe më vjen mirë që u plotësua kjo, por jo me meritën e dikujt këtu.

Është vullnet i KK të Gjilanit që anëtarët e familjeve Berisha dhe Malaj, respektivisht Hanifja dhe baca Rexhë të shpallen Qytetarë Nderi. Në emër të grupit të anëtarëve të AAK-së i jap mbështetje të plotë këtij propozimi.

Bajram Hasani – edhe unë jam i kënaqur pavarësisht shtyrjeve politike që u bënë dikush duke përkrahur më shumë njërin apo tjetrën familje, por në fund u arrit një marrëveshje. Mirëpo për ta dërguar amanetin e tyre në vend e kam një listë për nënshkrim të peticionit për mos krijim të “Zajednicës” dhe mos dhënie të territorit të Kosovës Malit të Zi. Ky peticion është për ta dërguar amanetin e këtyre Dëshmorëve në vend.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.2 e rendit të punës

Aprovohet pika 2. 2 e rendit të punës: Iniciativë për shpalljen Qytetar Nderi, znj. Hanife Malaj dhe Rexhep Berisha me të gjitha vota e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në seancë.

2.3 Propozim – buxheti për vitin fiskal 2016

Zijadin Maliqi- ky propozim –buxhet është punë e Komisionit për Buxhet dhe Financa, në të cilit Komision është kryetari i Komunës i cili sot nuk është në Kuvend për shkaqe familjare. Data e aprovimit nuk mund të shtyhet, sepse dita e fundit për dorëzim në MEF është 30 shtatori.

Buxheti për vitin 2016 është planifikuar në vlerë prej 21 milion e 578 mijë € dhe është një buxhet më i vogël në krahasim me buxhetin e vitit 2015. Arsyeje pse ky buxhet për vitin 2016 është më i vogël, sepse Qeveria e Kosovës e ka bërë rishikimin e buxhetit dhe e ka vërejtur se nuk janë të hyrat e planifikuara për vitin 2015 në harmoni me ato që mund të realizohen. Ky shkurtim të të hyrat dhe në raport me ato të hyra të cilat pas rishikimit është planifikuar dhe buxheti për vitin 2016, por edhe vlerësimet e hershme për vitin 2017 dhe 2018.

Ky buxhet shpërndahet për këto kategori të shpenzimeve; paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, subvencione dhe investime kapitale. Me përjashtim që vetëm te pagat dhe mëditjet nuk ka zbritje, sepse janë edhe të pamjaftueshme për vitin 2016, te kategoritë e tjera jemi munduar t’ i ruajmë investimet kapitale, duke i zvogëluar mallrat dhe shërbimet për afër 12% me qëllim që mos t’ i prekim investimet kapitale. Në përqindje pagat dhe mëditjet, kapin shumë prej 66. 9%, mallrat dhe shërbimet 11.8%, shpenzimet komunale, 2.63%, subvencionet 2.59% dhe shpenzimet kapitale 16.8%

Në vijim të fjalës së tij z. Maliqi dhe hollësi të tjera, sipas shifrave dhe tabelave lidhur me këtë raport e të cilin raport, anëtarët e Kuvendit e posedojnë me shkrim.

Avdyl Aliu- në emër të grupit të kuvendarëve të LDK-së po i jap disa vlerësime për buxhetin e vitit fiskal të vitit 2016. Falënderojmë drejtorin i cili na ka prezantuar një analizë për vijat buxhetore, projektet dhe mundësitë financiare për investime në vitin 2016. Ne sot e kemi përpara dokumentin më të rëndësishëm komunal e që duhet ta aprovojë KK, me kënaqësi i presim vërejtjet sugjerimet dhe vlerësimet për këtë dokument të rëndësishëm, sepse ky dokument paraqet një rëndësi të veçantë, sepse adreson projektet infrastrukture dhe zhvillimore për mirëqenie të gjithë qytetarëve të Komunës së Gjilanit. Ky buxhet i ka kaluar të gjitha procedurat e nevojshme dhe sot është për aprovim në KK.

U tha se kemi shkurtim buxhetor për 485 mijë €, por e cila mangësi u arsyetuar shumë mirë. Kjo nuk na pëlqen as neve dhe askujt, sepse të gjithë e kishim dëshiruar një buxhet sa më të madh, mirëpo duhet ta dimë se ky buxhet i paraqet mundësitë reale.

Ky shkurtim buxhetor nuk ka të bëjë vetëm me Komunën e Gjilanit, por në disa Komuna ky shkurtim është edhe më i madh. Askush nuk do të dëshironte që të planifikojmë diçka, kurse gjatë vitit të mos kemi mundësi për ta realizuar planifikimin tonë ashtu siç edhe ka ndodhur.

Shkurtimi buxhetor qëndron në mallra dhe shërbime duke u munduar që kategoritë e tjera të mos i prekim ose sa më pak që është e mundur. Edhe drejtori tha se do të punohet shumë gjatë vitit me ministrin përkatës për realizim të projekteve të shumta që janë në pritje dhe që janë identifikuar edhe nga qytetarët në dëgjimet dhe debate publike që i kemi mbajtur nëpër lokalitete. Nuk kam më tepër për të thënë, por iu ftoj që ta aprovojme buxhetin për vitin fiskal 2016 me vërejtje dhe sugjerimet e juaja.

Riad Rashiti- projekt buxheti për vitin 2016, i cili na ka ardhur si propozim i kryetarit të Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, është një planifikim shumë i dobët i buxhetit, është planifikim i fukarallëkut dhe i mbijetesës institucionale dhe fare nuk kemi të bëjmë me një stabilitet apo zhvillim të Komunës për qytetarët e Gjilanit në vitin që po vjen.

Komuna e Gjilanit për vitin 2016 e ka zvogëluar buxhetin për 485,067 euro më pak në krahasim me këtë vit, pra kufijtë buxhetor janë ulur dhe nuk janë rritur për 4.2 milion euro, ashtu siç propagandonte kryetari i Komunës me muaj të tërë gjatë këtij viti.

Pra nga 21,839,768 euro buxheti është zvogëluar në 21,354,701 euro.

Ndërsa planifikimi i të hyrave vetanake nuk është bazuar në mundësit reale që ka Komuna për të realizuar inkasimin nëpër sektorë të ndryshëm, por janë bërë disa ndryshime paushall në këtë planifikim të çuditshëm.

Planifikimi i të hyrave nga qiraja është zvogëluar për 20 mijë euro, nga 90 mijë në 70 mijë.

Të hyrat nga Zhvillimi Ekonomik po ashtu janë zvogëluar në planifikim për 20 mijë euro

Të hyrat në Arsim po ashtu janë planifikuar të zvogëluara për 20 mijë euro, ndërsa në shëndetësi janë zvogëluar për 60 mijë euro, ku nuk dihet cila është arsyeja e këtij planifikimi, a kemi të bëjmë me zvogëlim të shërbimeve në shëndetësi apo çka është në pyetje?

Ndërsa prapë edhe në këtë vit kemi rritje të madhe të planifikimit për të hyrat nga gjocat e gjykatave për 120 mijë euro më shumë, nga 180 në 300 mijë euro.

Te investime kapitale nga buxheti i Komunës së Gjilanit për vitin 2016, kemi po ashtu zvogëlim të planifikimit për 163,789 euro, nga 3,596,077 euro në 3,432,288 euro.

Nuk janë aspak të vërteta deklaratat e zyrtarëve të ndryshëm Komunal se në vitin 2016 do të ketë hov të investimeve kapitale, por është krejt e kundërta, do të ketë shumë më pak mundësi financiare dhe investime për të realizuar projekte të reja infrastrukturore.

Një çështje te planifikimi i investimeve kapitale për vitin 2016 është interesante dhe shtrohet pyetja se për cilat arsye në disa sektorë ka zvogëlim të dukshëm të buxhetit e në disa të tjerë ka rritje të theksuar.

P.sh. te Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka rënie të madhe të planifikimi i buxhetor për investime kapitale në vlerë prej 414,077 euro, ndërsa te Drejtoria e Shërbimeve Publike ka rritje të buxhetit për 168 mijë euro.

A ka të bëjë ky planifikim i buxhetit me ndërrimet e drejtorëve që janë bërë dhe me prejardhjen se nga cili subjekt politik vijnë ata? Sepse DZHE tani e udhëheq AAK dhe DSHP tani e udhëheq LDK...

Për vitin 2016 edhe te subvencionet po ashtu ka zvogëlim të buxhetit prej 120 mijë euro, ku nga 674 mijë ka rënë në 554,084 euro...

Planifikimi i subvencioneve për Kulturë, Rini dhe Sport është zvogëluar për 25 mijë euro, që tregon se vitin tjetër jo që nuk do të ketë përmirësim të gjendjes së rëndë në këtë sektor, por do të ketë edhe më tej përkeqësim, si për Teatrin Profesional të Gjilanit, Rininë dhe sportin i cili gjendet në gjendje jashtëzakonisht të rëndë, nga mungesa e mbështetjes institucionale e Komunës së Gjilanit.

Subvencionet për bujqësi janë zvogëluar po ashtu për 90 mijë euro, në krahasim me këtë vit që jemi tani. E që do të thotë se bujqit e Komunës së Gjilanit, do të kenë shumë më pak përkrahje për të punuar tokat e tyre, si dhe do të thotë që do të ketë më pak prodhim të produkteve bujqësore. Kësaj nuk i thonë zhvillim por stagnim dhe fukarallëk.

Planifikimi i projekteve të cilat do të investohen nga buxheti prej 3,432,288 euro për investime kapitale për vitin 2016, janë shpenzime buxhetore që kanë të bëjë pothuajse krejtësisht me mirëmbajtje dhe sanim të projekteve aktuale, apo të investimeve që janë bërë pas viteve paraprake dhe nuk shihet asnjë projekt i

ri, i cili pritet të realizohet për qytetarët e Gjilanit, të cilëve iu është premtuar shumëçka e gjithçka nga kryetari i Komunës...

Në listën e projekteve për vitin 2016 janë përsëritur projektet e viteve të kaluara, të cilat janë tenderuar në vitin 2014 njëherë, kanë nisur dhe dështuar, në vitin 2015 po ashtu janë tenderuar kanë vazhduar dhe nuk pritet të përfundojnë as në këtë vit, kështu që prapë i keni futur për të tretin vit radhazi në planifikim të njëjtat projekte, sepse keni dështuar në realizimin e tyre, si p.sh, ndërtimi i fushave sportive nëpër fshatra dhe qytet...

Për projektin historik të lumit Mirusha, prapë i keni planifikuar vetëm 100 mijë euro, sikurse që deri në vitin 2018 i keni planifikuar vetëm nga 100 mijë euro për këtë projekt, kështu që me ju dhanë ymër zoti juve dhe me ju dhanë pushtet përsëri qytetarët e Gjilanit, ju me këtë ritëm edhe 20vjet nuk keni me mund me përfund këtë projekt dhe kanë me vuajtur mijëra qytetarë të Gjilanit duke duruar kundërmimin që po e tmerron qendrën e qytetit dhe fshatrat Malishevë, Uglar dhe Pogradec.

- Për projektin e Tregut të Gjellbër asnjë euro nuk e keni planifikuar...

- Për projektin e Zonës Ekonomike, as përmend kund nuk e keni, se lëre me planifiku në buxhet ndonjë cent të atyre eurove, kështu që ju as që mendoni dhe as që keni idenë çka do të thotë zhvillim ekonomik të një vendi...

- Për investime në projektet e PPP askund nuk shihet që keni planifikuar edhe pse për këto projekte nuk do të duhej të shpenzohej nga buxheti komunal, mirëpo si investime kanë dështuar plotësisht...sikurse

- Projekti i kompleksit të shkollave të Mesme

- Projekti i transportit publik

- Projekti i ndërtimit të qendrës rekreative përmes PPP, te salla e sporteve në Gjilani

- * Në listën e projekteve të DZHE, askund nuk shihet ndarja buxhetore për përkrahje të bizneseve në kredimarrje, që në këtë vit ju e keni miratuar në Kuvendin Komunal dhe i cili dështoi ende pa u nis fare...

- * Me një fjalë, kjo qeverisje Komonale me këtë planifikim buxhetor, nuk ka asnjë ide apo projekt të vetëm zhvillimor për Gjilanin, që do të ndikonte në krijimin e vendeve të reja të punës dhe në ngritjen e mirëqenies sociale...

- * Por me këtë buxhet të vitit 2016, pritet të ketë vetëm rritje të numrit të vizitave turistike të kryetarit Haziri jashtë vendit, ku do të shpenzohen dhjetëra mijë euro apo rreth 50 mijë euro nga parat e qytetarëve të Gjilanit dhe pa asnjë dobi për ata, sepse s'ka hajr hiq prej kësaj pune qe dy vite...

- * Me këtë buxhet të fukarallëkut pritet të përkrahen të rinjtë e politikës, që do të jenë vetëm në shërbim të Lutfi Hazirit, ndërsa pjesa tjetër, dërmuese e rinisë së Gjilanit nuk do të ketë asnjë lloj mbështetje financiare për vitin 2016...sepse nuk është planifikuar asgjë konkrete...

- * Sporti Gjilanas do të vazhdojë të përballet edhe më shumë me mungesë të përkrahjes financiare nga Komuna...

Pra me këtë planifikim buxhetor, Gjilani vazhdon të katandiset edhe më shumë nga keq qeverisja dhe nga keq menaxhimi, shpenzimi i pakontrolluar i buxhetit komunal dhe mostrajtimi i barabartë i qytetarëve të Gjilanit...

Politika dhe turizmi dhe vetëm politika e vizitat turistike do të jenë prioritet i prioriteteve që ka kryetari Lutfi Haziri e që këtë qëllim të tij personal ndoshta edhe do të mund ta realizojë, por asnjë prioritet tjetër që kanë nevojë qytetarët, ky kryetar Komune nuk do të mund që ta realizojë, me këtë qasje joserioze dhe totalisht të papërgjegjshme ndaj 90 mijë qytetarëve të Gjilanit.

Krenare Latifi- ne si grup opozitare jemi kundër këtij buxheti i cili na është ofruar për miratim, prandaj ne do t' i japim vërejtjet, sugjerimet, propozimet tona, që mendojmë se janë ne interes të qytetareve të Komunës së Gjilanit.

Kur shohim tabelën e kufjeve buxhetore vërejmë se Komuna nuk e ka trendin e rritjes së Buxhetit të Komunës, por përkundrazi ka parashikuar zvogëlim të buxhetit prej 21,839,769.00 sa ka qenë e planifikuar në vitin 2015, ndërsa për 2016 është paraparë buxheti të jete për 21,354,701.00 e që i bie diku rreth 2.22% më pak se vitin e kaluar.

Ne parim ne si grup opozitare mendojmë se ky planifikim për vitet e ardhshme do të duhet të ketë rritje ne investimet kapitale dhe të ketë ulje ne mallra dhe shërbime. Ne konkretisht paraqesim vërejtjet tona nëpër disa sektorë.

Dua të ndalem ne sektorin e Arsimit, sepse mjetet e parapara për tu shpenzuar në shumën 2,844,157.00 nga të hyrat vetanake dhe grandit i përgjithshëm mendojmë se janë te pakta dhe kërkojmë që të ketë rritje duke i marrë parasysh nevojat e shumta për ndërtimin e çerdheve, shkollave, sallave e terreneve sportive, kompletimin e laboratorëve, kabineteve dhe mirëmbajtja në infrastrukturën shkollore duke e parë se buxheti i planifikuar në kategori ekonomike konkretisht shpenzime kapitale është vetëm 260.000.00 apo në përqindje vetëm 2.2%

Po ashtu vërejtjeje të njëjta kemi edhe ne sektorin e shëndetësisë ku buxheti i planifikuar prej 2,527,106.00 do të shpenzohet ne kategori ekonomike, paga mallra dhe shërbime, por nuk iu është kushtuar rendësi shpenzimeve kapitale e që janë ndarë vetëm 40.000.00 apo 1.5% nga buxheti i shëndetësisë .

Ne se grup mendoj se është nënvlerësuar ky Sektor i Mirëqenies dhe Shëndetësisë për qytetarët ku i bie të jenë shpenzime kapitale mujore për bazë vetëm 3300.00

Po ashtu do të ndalem pak edhe tek investime kapitale që janë te planifikuara për 2016 3,432,288.00 po ndalem nëpër disa sektorë shumë te rëndësishëm p.sh Drejtoria e Administratës së Përgjithshme 160.000.00 ku kemi te pika 4 Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit të tretë janë planifikuar 120.000.00, ku gjithashtu Drejtorisë së Bujqësisë iu janë ndale 120.000.00. A mendoni se është kjo ndarje e drejtë duke e ditur që bujqësia është lënë anash, ne mendojmë se kjo drejtori duhet te ketë prioritet se është një sektorë që ndikon në zhvillimin ekonomik të një vendi dhe jo të krahasohet me projektin e rrugëve te rendit të tretë ku të gjithë jemi dëshmitarë që as rrugët e rendit të parë nuk janë ne gjendje të mirë.

Po ashtu te investimet kapitale duhet të përmendim edhe investimet rreth Lumit Mirusha që janë ndarë 100.000.00 € në buxhetin e paraparë. Çka po ndodhe me këtë projekt? Ky është problem në vete!

Po ashtu edhe pajisje për nevoja te Komunës janë ndarë 80.000.00 për çfarë pajisje konkretisht bëhet fjalë këtu, prandaj për këto pajisje, automjet për zjarrfikës ne propozoj ulje këtu.

Shpronësimi (eksproprijimi) i tokës për interes publik është 450.000.00, që nuk është e specifikuar për çka konkretisht kërkojmë nëpër këta sektorë të na sqaroni?

Gjithashtu kërkojmë ne emër te grupit që për Varrezat e Dëshmorëve te planifikohen mjete të veçanta

Ibish Ibishi- për sa e dëgjuam drejtorin i cili na i dha disa sqarime përkitazi me buxhetin e vitit 2016, por i dha edhe disa informata përkitazi me dëgjimet publike lidhur me tërë këtë dokument e të cilin ne sot po planifikojmë që ta votojmë një buxhet të planifikuar. Unë do të ndalem tek dëgjimet publike, sepse u tha se janë mbajtur 5 dëgjime publike me qytetarë dhe ka pasur takime pune me këshillat e fshatrave, prandaj i kam disa pyetje për drejtorin: “ sa kanë ndikuar në planifikim të këtij buxheti këshillat ose sa janë plotësuar kërkesat që kanë dal nga këto takime “ ? “ A kanë ndikuar ato debate dhe sa janë marrë parasysh ato kërkesa”?

Unë jam punëtor i shëndetësisë dhe për këtë sektor e kam një pyetje: “ si është i planifikuar dhe në bazë të cilave kriteret ndalet grandit për shëndetësi për Komunën e Gjilanit” ?

Për dallim nga viti 2015, shëndetësia për shpenzime kapitale për 40 mijë €, ka dallim në vitin 2016 e që do të thotë për 40 mijë € ka më pak buxhet. Ne e dimë se kërkesat për shëndetësi janë të mëdha, sepse edhe në debate ka pasur kërkesa për shëndetësi, prandaj ka qenë deshtë që ky buxhet të mos zvogëlohet, por të rritet edhe më tepër. Me rritje të buxhetit në shëndetësi, mendoj se dhe shërbimet dhe çdo gjë që ka të bëjë me shëndetësinë do të ishin edhe më cilësore dhe më efikase.

Shëndetësia është e organizuar përmes QMF-ve , nëpër fshatra, prandaj kam pyetje se : “a është menduar se nëpër fshatra me një numër të banorëve më të madh të organizohet ndonjë shërbim shtesë nëpër ato fshatra”? Si shembull i tillë është shërbimi i stomatologjisë, i EKG-së i laboratorit apo ndonjë shërbim i cili do të i kishte mundësuar qytetarit që të merr shërbime më të mira dhe më të shpejta. Si pyetje tjetër

për drejtorin: “ a është planifikuar rritje e pagave për vitin 2016 për punëtorët e shërbyesve civil”? Sipas këtij Raporti mbi 136 mijë e 231 € kemi mjete më shumë se vitin e kaluar të raportuara?

Shukrie Rapuca- sa i përket këtij buxheti i cili është planifikuar për vitin 2016, unë i ka disa vërejtje e të cilat kryesisht kanë të bëjnë me bujqësinë dhe për kulturë, rin dhe sport.

E para vërejtje është se zvogëlimi gati përgjysmë i buxhetit për subvencione në bujqësi.

Në vitin 2015 subvencione për bujqësi kanë qenë 280 mijë €, kurse për vitin 2016 në vend se të rritet buxheti, ai është zvogëluar përgjysmë ose me shifra ky buxhet për vitin 2016 është 190 mijë €.

Ky buxhet në asnjë mënyrë nuk ka qenë deshtë të zvogëlohet, por ka qenë deshtë të rritet edhe më tepër. Premtimet e kryetarit për investime në bujqësi gjatë fushatës elektorale kanë qenë 1.5 milion € investime në bujqësi me të cilat premtime edhe i ka fituar votat. Mirëpo dallimi në mes 1.5 milion investime në bujqësi dhe 190 mijë € të realizuara është tepër i madh! Kërkoj për ta ditur nga drejtori se a është ai që ka kërkuar zvogëlim të buxhetit, apo dikush tjerët?

E njëjta gjë ka ndodhur edhe me buxhetin për kulturë, rini dhe sport, sepse edhe për këta sektorë buxheti për vitin 2015 ka qenë 225 mijë €, kurse për vitin 2016 janë planifikuar vetëm 200 mijë €.

Me të vërtetë kur i kemi këto të dhëna dhe kur analizojmë buxhetin për bujqësi, kulturë, rini dhe sport e vërejmë se sa serioze është kjo qeverisje komunale. Të zvogëlohet buxheti për bujqësi e cila degë aktualisht pothuajse është e vetmja që premton rritje të zhvillimit ekonomik, nuk kërkon koment ! Në anën tjetër të zvogëlosh atë pak buxhet për kulturë, rini dhe sport në kohën kur rinia e jonë është e pa perspektivë dhe e margjinalizuar nga shoqëria totalishtë dhe e lënë pas dore nga institucionet dhe zgjidhje të vetme po e sheh ikjen nga vendi, sepse nuk ka tjetër rrugëdalje, prandaj edhe kjo nuk kërkon koment ! Janë plotë argumente që flasin për jo seriozitetin e kësaj qeverie, por të injorosh bujqësinë ku mbi gjysma e qytetarëve i sigurojnë të ardhurat prej saj dhe të injorosh rininë kur gjendja e saj është alarmante, kjo me të vërtetë nuk ka asnjë kuptim.

Kolegë të nderuar kërkoj nga ky Kuvend që buxheti për bujqësi për vitin 2016 të rritet së paku në nivelin sa ka qenë vitin e kaluar dmth. nga 190 mijë € sa është planifikuar të rritet në 280 mijë, kurse për rini, kulturë dhe sport të rritet nga 200 mijë sa është planifikuar së paku të arrijë në shumën e 300 mijë € për vitin 2016.

Fehmi Sylejmani- lidhur me projekt propozimin e buxhetit të Komunës për vitin fiskal 2016, vëmendjen e juaj kolegë kuvendarë do ta përqendroj në dy çështje të rëndësishme: Shpenzimet kapitale dhe subvencionet.

Shpenzimet kapitale

Prej shumë së përgjithshme të buxhetit komunale për vitin 2016, që është 21 milionë e 354 mijë e 701 euro, shpenzimet kapitale kapin shumën 3 milionë e 432 mijë e 288 euro, kurse subvencionet e përbëjnë shumën prej 554 mijë e 86 euro. Shuma e mjeteve financiare prej 3 milionë e 432 mijë e 288 euro e destinuar për shpenzime kapitale sipas fushave të Administratës Komunale është ndarë si vijon:

1. Shërbimet Publike: 1 milion e 35 mijë euro
2. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme 160 mijë euro
3. Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, 120 mijë euro
4. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik 1 milion e 100 mijë
5. Drejtoria për Kadastër dhe Pronë 450 mijë
6. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit 267 mijë
7. Shëndetësia 80 mijë
8. Arsimi 260 mijë
9. Kultura, Rinia dhe Sporti nuk ka

Në faqen 9 të projekt-buxhetit për vitin 2016, në mënyrë të përgjithësuar janë paraqitur projektet e infrastrukturës komunale dhe të objekteve tjera komunale, ku në mënyrë të përgjithësuar janë paraqitur

emërtimet e projekteve dhe shuma e mjeteve të destinuara për atë projekt, por jo edhe parametrat tjerë siç janë lokacioni i objektit ose rrjetit, gjatësia, gjerësia ose çmimi sipas tregut.

Në vazhdim po i paraqesë disa shembuj konkretë të mangësive që i ka ky projekt- buxhet.

1. Në faqen 9 për Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme janë planifikuar 160 mijë euro, por fare nuk figuron se për çfarë destinomi do të shpenzohen ato mjete
2. Në projektin e emërtuar “Sanimi i rrugëve, trotuareve dhe parqeve në qytet dhe fshatra për të cilën janë planifikuar të shpenzohen 400 mijë euro, fare nuk janë emërtuar lokacionet, rrugët të cilat do të shtrohen, lokacioni i parqeve, cilat parqe, lokacioni i trotuareve, gjatësia dhe gjerësia e trotuareve.
3. Sanimi i ndriçimit publik, janë paraparë 60 mijë euro, ndërkohë që nuk paraqiten se në cilat fshatra, në cilat rrugë dhe lagje të qytetit do të instalohet rrjeti i ndriçimit publik(Rruga e Prishtinës, Rruga qarkore, rruga Gjilan –Bujanoc si dhe shumë lagje dhe rrugë tjera janë pa ndriçimi).
4. Sinjalizimi horizontal –vertikale dhe numërimi i objekteve, vlera 150 mijë, por nuk janë të paraqitur lokacionet.
5. Rregullimi dhe hapja e rrugëve të trendit të tretë, 120 mijë euro. Fare nuk jepen as për këtë projekt lokacionet e as emërtimet e tyre.
6. Rregullimi i infrastrukturës nëntokësore, 80 mijë(kanalizimi fekale, atmosferik, rrjeti i ujësjellësit e tj). Fare nuk përmenden projektet, lokacionet e as gjatësia e tyre.
7. Halla dhe terrene sportive, 85 mijë euro. Çfarë paradoksi kemi këtu? Si mund të ndërtohet një sallë me 85 mijë euro, kur e dimë të gjithë se sigurisht për një sallë të re duhen 200 mijë euro. Edhe këtu askund nuk figuron se ku janë lokacionet për ndërtim?
8. Ndërtimet e urave, 70 mijë euro(ndritmi i urës në Dobërçan dhe Malësisë së Karadakut).
Nuk jepen fare parametrat e domosdoshëm, gjatësia, gjerësia dhe lartësia. Është e çuditshme se si mundet të ndërtohet një urë me 70 mijë euro?
9. Në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, 1 milion e 35 mijë euro. Në këtë sektorë të kësaj drejtorie fare nuk është dhënë destinimi për asnjë metalik nga shuma e përgjithshme.
10. Drejtoria për Bujqësi, 120 mijë, kjo shumë e paraparë për rregullimin e infrastrukturës bujqësore. Ndërtimin e rrugëve për nevoja të bujqësisë pa paraqitur asnjë lokacion e as gjatësinë e rrugëve apo llojin e tyre.
11. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, 1 milion e 100 mijë. fare nuk jepen arsyetime se ku do të investohen këto mjete, në çfarë objekti dhe në çfarë lokacioni?
12. Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, 450 mijë, njëjtë si të tjerat, pas kurrfarë përshkrimi se ku do të përfundojnë këto mjete?
13. Drejtoria për Urbanizëm, 267 mijë, po ashtu pa shënime.
14. Drejtoria për Shëndetësi, 40 mijë, nuuk figuron asgjë.
15. Drejtoria e Arsimit, 260 mijë, Rekosntruimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore si dhe pajisje shkollore. Cilat institucione shkollore do të riparohen, cilat do të mirëmbahen, cilat do të pajisen me mjete shkollore, këto askund nuk figurojnë në këtë projekt?

Subvencionet

Shumë e përgjithshme e subvencioneve për vitin fiskal 2016 është paraparë në lartësi prej 674mijë euro të shpërndara në 6 fusha të Administratës Komunale duke përfshi edhe Zyrën e Kryetarit.

Sikurse shpenzimet kapitale, po ashtu edhe subvencionet fare nuk janë destinuar për projekte konkrete, por janë dhënë vetëm shumat e përgjithshme të ndara në 6 fusha, përkatësisht 6 pjesë.

Një praktikë e tillë e mos përcaktimit të projekteve konkrete, e cila ka qenë e pranishme edhe në qeverisjet e kaluar, paraqet një papërgjegjësi të Drejtorisë Komunale të Financave, si sponzoruese e këtij projekt-buxheti, kryetarit të Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe komiteteve tjera(mbase shumë pak prej tyre kanë reaguar), OSBE dhe Shoqëria Civile.

Kjo mënyrë e prezantimit të këtij buxheti pasqyrohet në mosrespektimin e parimit të transparencës në Komunë të përcaktuar me LVL, qarkoren buxhetore ppr 2016, Udhëzimin administrativ për transparencë në Komunën e Gjilanit.

Miratimi i buxhetit të Komunës për vitin e ardhshëm, po ashtu edhe buxhetet e viteve të mëparshme në forma të tilla, pa projekte konkrete, pa lokacione dhe të paspecifikuara në mënyrë detale kanë krijuar dhe përherë do të krijojnë kushte për korrupsion si nga ekzekutivi si dhe nga ana e operatorëve, përfituesve potencial të tenderëve, ngase në format e këtij projekt-buxheti mungon transparenca.

Ismet Hajdini- unë e kam vetëm një pyetje të shkurtër për drejtorin e Buxhetit: “te planifikimi i të hyrave vetanake te Drejtoria e Inspeksionit janë të planifikuara 45 mijë € e cila shumë ka qenë edhe viteve të më parme, por tash pasi katër sektorët e Inspeksionit janë shpërndarë, por a është llogaritur që këto 45 mijë € do të inkasohet edhe nëpër drejtori të tjera përkatëse ku janë shpërndarë këta inspektorë?”

Arben Maliqi- unë e përshëndes Raportin e drejtorit dhe e kam përmendur edhe më herët që Gjilani ka pasur fat të ketë drejtor shumë të mirë për buxhet dhe financa dhe një ndër këta është edhe drejtori aktual i cili është njeri profesionist për buxhet dhe financa.

U përmend zvogëlimi i buxhetit, por nuk ka zvogëlim të buxhetit, por faji nuk qëndron vetëm te pozita apo te kryetari i komunës, apo te ne kuvendarët e pozitës, por faji është edhe te disa njerëz të cilët i kemi zgjedh në nivel qendror (deputet që po i themi) e të cilët duhet ta aktualizojnë këtë problematikë për të mirë të qytetarëve të Komunës sonë. Ata njerëz votat i anë marrë këtu dhe kemi një qeveri të përbashkët PDK- LDK dhe ata duhet të mendojnë për Gjilanin dhe mos ta lënë në këtë gjendje. Shqetësim për mua paraqet grandin e Arsimit, sepse në kohë të fundit po kërkohet një cilësi në arsim, por për ta pasur një performancë më të mirë, atëherë duhet të kemi mjete më shumë.

Te ne ende ka shkollë që punojnë me tri ndërrime, ende nuk kemi fusha të mirëfillta sportive, nuk kemi palestra, nuk i kemi kabinetet siç duhet, kurse në anën tjetër po kërkohet cilësi në arsim.

Çdo kush gabon nëse thotë se nuk ka cilësi në Arsim nëse nuk ka kushte elementare. Unë kërkoj një përgjigje nga drejtori përkitazi me projektet të cilat kanë mbetur në gjysmë se a do të përfundojnë dhe çka do të ndodh me ato projekte?

Problem tjetër për Komunën tonë është edhe shpronësimi, prandaj kam një pyetje sa mjete janë ndarë për shpronësim, sa qytetarëve i kemi borxh dhe a pritet që në ndonjë të afërme t’i kryejmë këto obligime?

Fatbardhë Selmani- planifikimi i buxhetit për shëndetësi ka shumë për të thënë dhe jo ashtu siç tha z. Maliqi që ndryshimet për shëndetësi sa i përket buxhetit janë të vogla? Vetëm për investime kapitale buxheti është përgjysmuar prej 80 mijë € në 40 mijë €. Gjithashtu edhe për mallra dhe shërbime buxheti është zvogëluar për 40 mijë €. Nëse e krahasojmë buxhetin e vitit 2015 me atë të vitit 2016 ka zvogëlim të buxhetit për 80 mijë € në sektorin e shëndetësisë.

Buxheti i ndarë për listat e projekteve për vitin 2015 nuk shihet askund? Kam pyetje për drejtorin se sa mjete janë planifikuar për shoqatat e personave me nevojë të veçanta, sepse për subvencione janë planifikuar 109 mijë € e cila shumë është shumë e vogël, sepse kështu ka ndodh edhe në vitin që po e lëmë pas, sepse për subvencione janë planifikuar 100 mijë €.

Gjithashtu edhe buxheti për kulturë, rini dhe sport është zvogëluar për 25 mijë €, te subvencionet gjithashtu, por buxheti është zvogëluar edhe për mallra dhe shërbime të kësaj sektori. Po shihet se me këtë buxhet së pari klubet sportive me vështirësi do të vazhdojnë për të funksionuar dhe mund të rrezikohet edhe shuarja e disa klubeve sportive ashtu siç ka ndodh edhe gjatë këtij viti.

Leonore Bunjaku- edhe pse planifikimi i buxhetit për investime kapitale është mbi 3 milion €, shumica e këtij buxheti po thuhet se po shpenzohet për mirëmbajtje dhe riparim të rrugëve, por kjo nuk po ndodh dhe nuk po shihet në rrugët të cilat kanë qenë të projektuara dhe kanë qenë para implementimit në ish qeverisje. Është fjala për rrugën e Tregut të Gjellbër dhe rrugën e Tregut të Drunjve deri te tranziti.

Nuk e di se çka po ndodh, sepse këto projekte gati kanë qenë para implementimit.

Bujar Nevzadi- unë e kam lexuar dhe analizuar propozim- buxhetin dhe i kam disa pyetje për drejtorin e financave; 1. Sa mjete i ka marrë Qeveria Komunale nga Qeveria e Kosovës ? Ne kemi dëgjuar gjatë planifikimit të buxhetit për vitin e kaluar se nga Qeveria do t' i marrim 6 milion€ dhe kështu ka thënë kryetari i Komunës.

2. Sa është i faturuar tatimi në pronë ? 3. Sa janë obligimet e qytetarëve ndaj tatimit në pronë?

4. Sa janë obligimet e bizneseve ndaj Komunës ? Ne nganjëherë po e shohim kryetarin e Komunës se po viziton bizneset, kurse ne e dimë se ato biznese asnjë qindarkë nuk ia kanë dhënë fondit të Qeverisë Komunale. Unë saktë e di që ka biznes që asnjë cent nuk e ka dhënë, kurse kryetari po shkon në vizitë për promovim.

Në seancën e radhës kërkoj nga drejtori që ta sjell listën e obliguesve që i kanë mbi 1 mijë € tatim në pronë për ta parë se kush janë ata ? Sa i përket debatit publik, të cilin fakt e përmendi kolegu Ibishi edhe unë kam qenë në një debat dhe ato janë mbajtur sa për të thënë, sepse nuk janë paraqitur kërkesat e qytetarëve. Në fund po del një konstatim që e thanë të gjithë se ky buxhet nuk është buxhet i zhvillimit, por është buxhet i fukarallëkut.

Ziadin Maliqi- unë nuk do të përgjigjem në disa pyetje që kanë të bëjnë me projektet, sepse drejtorët e tjerë janë të obliguar të japin përgjigje, por unë do të përgjigjem në pyetje që janë bërë për buxhet.

Që në fillim unë e thash se ky buxhet nuk është i nevojave të Komunës, por është buxhet i mundësive dhe formula e Qeverisë e ka dhënë këtë buxhet.

Nuk është anashkalluar Komuna e Gjilanit në këtë aspekt, por Komuna e Gjilanit qëndron më mirë me grande se Komunitatet e tjera në Republikën e Kosovës. Në buxhetin e Kosovës është punuar për një stabilitet, për një disiplinë buxhetore dhe nuk është lejuar që të parashihen mjete të cilat nuk mund të realizohen, pastaj ato të mbesin vetëm në letër. Sa i përket pyetjes për thyerje të kufijve buxhetor e kam thënë edhe më parë se nuk mund të thyhen kufijtë buxhetor sa i përket granteve, sepse ekziston formula dhe buxheti krijohet ashtu. Mirëpo me këtë formulën sidomos tek arsimit nuk jemi të kënaqur si Komunë, sepse na dëmton shumë. Thyerja është bërë në forma të tjera, ajo thyerje është bërë përmes ministrive dhe po e sqaroj se kryetari i Komunës gjatë vitit 2015 ka arrit t' i realizojë përmes ministrive mbi 3 milion e 663 mijë €, duke e përjashtuar Burgun e Gjilanit, sepse ky projekt është realizuar më herët. Këtë mund ta konfirmojë projekt për projekte pse janë lëshuar ato mjete dhe ata projekte janë në realizim e sipër e të cilat projekte i lexon z. Maliqi: rruga Pogragjë- Bilenicë, Lagja e Tetë në Gjilan, rrugët nëpër fshatra 1 milion e 170 mijë €, kurse rrugët në qytet 720 mijë €, por në vijim z. Maliqi i numëron edhe shumë projekte të tjera.

Ne gjithashtu shpresojmë që edhe këtë vit që përmes vijave ministrore të realizohen shumë projekte.

Sa i përket të hyrave ka dallime në krahasim me vitin e kaluar, sepse kur planifikohet diçka duhet bazuar diku, prandaj ne bazë e kemi marrë gjashtë mujorin e vitit 2015 dhe në bazë të kësaj periudhe kemi planifikuar për vitin 2016.

Një pyetje ishte për bujqësinë, por ne është deshtë të zvogëlojmë për çdo kategori të buxhetit nga pak mjete, me përjashtim të pagave. Pagat nuk kanë rritje, por rritjen e ka bërë 0.5% për përvojë e që ka kushtuar mbi 80 mijë €. U tha se për çdo kategori është deshtë të zbritet diçka, sepse grandit i Qeverisë është për 485 mijë € më i vogël. Për këtë arsyeje në çdo sektor u desh të bëjmë zvogëlime si në shëndetësi, arsim, por edhe në bujqësi.

Sa i përket shpenzimeve luksi ka mbaruar, sepse asnjë drejtorë asnjë kafe nuk e paguan nga buxheti askush nuk merr mbushje për telefon dhe shpenzimet i kemi reduktuar në maksimum, por ne duhet edhe të punojmë, kurse për pa shpenzuar nuk punohet.

Të hyrat vetanake janë rritur në një shumë jo të madhe, për 150 mijë €.

Sa i përket projekteve ne i kemi mbajtur disa dëgjime publike prej të cilave, 4 në fshatra dhe një në qytet, por ne jemi duke i marrë kërkesat edhe nga lokalitetet e tjera dhe pas marrjes së kërkesave, Komisioni i buxhetit do të bëjë planifikimin e prokurimit i cili planifikim do të paraqitet edhe para

Kuvendit. Është e vërtetë se i kemi zvogëluar subvencionet, sepse është paraqitur nevoja për t' i zvogëluar.

Vjollcë Jakupi- Koordinatorë Komunale Kundër Dhunës në Familje – Pranë Zyrës së Kryetarit të Komunës . Ekziston strategjia kundër dhunës në familje që është miratuar nga KK, por sot kërkesa ime që i përfaqësoj 13 institucione komunale dhe tri OJQ është: që së paku të financohet një pesë e Strategjisë Komunale nga Kuvendi i Komunës. Kjo Strategji financohet edhe nga ambasadat e huaja, por participuese e kësaj strategjie duhet të jetë edhe KK. Kërkoj nga KK që të jetë për këtë Strategji me një shumë të cilën do ta përcaktomë me drejtorin e buxhetit.

Valentinë Bunjaku Rexhepi- ne duhet të dimë se çka po votojmë sa është shuma dhe pasi të konsultohemi me buxhetin do ta shohim mundësinë e shumës së financimit.

Riad Rashiti- nuk dua të polemizoj me drejtorin, por atë që po e thotë se Komuna e Gjilanit nuk është anashkaluar, ne dhe kur kemi qenë në pozitë kemi shprehur pakënaqësi duke filluar nga kryetari e më poshtë, sepse nuk kemi qenë të kënaqur dhe kemi kërkuar më shumë. Sot të thuhet se ne jemi të kënaqur dhe Gjilani krahasuar me komunat e tjera është mirë, kur gjithnjë është në zbritje sa i përket grandeve është absurd. Unë mendoj se është më mirë se Leposaviçi, Ranilluku, Klllokoti, por krahasuar me komunat e mëdha, Gjilanit është anashkaluar shumë.

Sa i përket thyerjeve buxhetore, ne nuk kemi thënë thyerje buxhetore, por ka thënë kryetari i juaj, prandaj drejtori duhet t' i sqarojë atij se çka janë thyerjet buxhetore dhe jo neve ! Kryetari po deklaroi se ka thyerje buxhetore, por ne e dimë se thyerjet janë bërë përmes ministrisë, por këto thyerje nuk janë bërë vetëm këtë vit, por janë bërë për çdo vit. Për çdo vit ka pasur projekte që janë kryer përmes ministrisë së është projekti i Burgut i cili është bërë në kohën tonë, janë fushat sportive siç është në Zhegër. Jam i sigurt se e dinë drejtori se ato projekte janë të nënshkruara në Memorandum në mes të Komunës së Gjilanit kur kemi qeverisur ne dhe Ministrisë së Infrastrukturës kur kemi qeverisur ne.

U fol për planifikimin e të hyrave dhe u tha se është marrë për bazë 6 gjashtë mujori i këtij viti dhe është planifikuar buxheti për vitin e ardhshëm. Unë mendoj se kjo nuk është profesionale, sepse është shumë e rëndë të planifikohet në këtë mënyrë çka do të ndodh si duhet të punohet në vitin e ardhshëm.

Sa i përket luksit, unë e di që çdo herë e keni ngrit çështjen tek ushqimi dhe te pijet, kjo është e vërtetë, ne asgjë nuk kemi mohuar, por atëherë është punuar shumë, ju nuk merrni mbushje, por nuk e di sa po punoni dhe sa po i sillni të mira qytetit? Drejtorët po iu ndërrohen çdo tre muaj, sepse nuk mund të qëndrojnë, sepse nuk punohet për pa ngrënë dhe pa pirë dhe pa pasur shpenzime, prandaj edhe ju hani sa të dëshironi, por punoni shumë.

Ziadin Maliqi- sa i përket anashkalimit të Komunës që po e thotë Riadi, unë nuk e di si e ka kuptuar, por për mos anashkalim e thash për grandin dhe jo për pjesën tjetër të investimeve.

Komuna e Gjilanit e pamë sa e ka buxhetin mbi 21 milion e 500 mijë €, por unë po i bëj disa krahasime me komunat të cilat përfaqësoj janë të njëjta. Komuna e Gjakovës i ka 20 milion e 200 mijë €, Komuna e Pejë i ka 20 milion e 220 mijë €, Komuna e Mitrovicës i ka 16 milion e 272 mijë € dhe kështu me radhë. Pak më tepër ka Ferizaj, por Ferizaj i ka 110 mijë banorë dhe në këtë komunë 20 mijë banorë janë më shumë, prandaj sipas formulës ka buxhet më shumë.

Nga këto shifra po vërtetohet se Komuna e Gjilanit nuk është anashkaluar sa i përket grandit.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.3 me vërejtjet e dhëna nga anëtarët e Kuvendit.

Aprovohet me vërejtjet e dhëna nga kuvendarët pika 2.3: Propozim - buxheti për vitin fiskal 2016, me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, 9 janë kundër, kurse të tjerët abstenuan.

2.4 Propozim vendimi për caktimin e përbërjes së Komitetit konsultativ të ekspertëve të planifikimit hapësinor,

Avdyl Aliu- menjëherë pas marrjes së vendimit për formimin e Komitetit Konsultativ të Ekspertëve si dhe pas vendimit për shpallje të konkursit për këtë Komitet, KK procedoi më tutje në seancën e radhës për themelimin e panelit për përzgjedhje të anëtarëve të Komitetit Konsultativ të Ekspertëve të Planifikimit Hapësinor në përbërje që e posedoni në vendim.

Paneli në takimin e parë të mbajtur më 31.7.2015 e ka bërë intervistimin e kandidatëve për këtë Komitet, pastaj i kemi shtjelluar dosjet e tyre sipas konkursit, kurse në takimin e dytë të mbajtur më 4.8.2015, paneli e ka nxjerr listën dhe i ka propozuar 7 anëtarë në këtë Komitet. Të gjitha procedurat e parapara janë përfill si është më së miri dhe secili anëtarë i ka bërë vlerësimet në mënyrë të pavarur dhe në fund me koncenzues të plotë KK-së ia kemi propozuar këta emra: Selman Sejdiu, Afërditë Daku, Enis Shurdhani, Nexhmedin Bllaca, Abdyl Hajrullahu, Avni Aliu dhe Fitore Haliti. Përbërja e panelit ka qenë sipas reflektimit politik dhe një anëtar nga Shoqëria Civile.

Riad Rashiti- edhe unë në emër të grupit po e jap mendimin tim për zgjedhje të këtij Komiteti dhe po theksoj se edhe unë kam qenë një prej anëtarëve të Komisionit Komunal për intervistimin e anëtarëve të këtij Komiteti, por për shkaqe personale nuk kam pasur mundësi të marrë pjesë në këtë panel.

Ne e vlerësojmë se ky vendim për përzgjedhje të këtij komiteti është i papranueshëm, sepse përbërja e këtij Komiteti është jo adekuat dhe joprofesional. Këta emra që janë propozuar janë njerëz që nuk i përjasin detyrës dhe kompetencave që ka ky komitet për punën që do ta bëjë në të ardhmen. Nga 7 anëtarë sa i ka ky Komitet 5 prej tyre nuk janë në profesion dhe nuk janë ekspertë të arkitekturës dhe nuk kanë njohuri për planifikim hapësinor.

Tre anëtarë janë me Fakultet të Edukimit, një me Fakultet të Sociologjisë, kurse njeri të Gjeografisë.

Për vlerësimin tonë kjo përbërje është e dështuar qysh në start dhe ne nuk pajtohemi që ky komitet ta ketë këtë përbërje joprofesionale për pa pasur asnjë vërejtje ndaj individëve të cilët janë zgjedh, por përgatitje e tyre profesionale nuk është në harmoni me punën që duhet bërë ky komitet. Ne nuk e pranojmë këtë propozim dhe jemi që konkursi të përsëritet dhe të zgjidhet një komitet krejt tjetër me përgatitje profesionale adekuate.

Fehmi Sylejmani- edhe ne si subjekt politikë mendojmë se kjo përbërje që iu është afruar Kuvendit për këtë komitet, nuk pasqyron realitetin e këtij Komisioni të ekspertëve, sepse nuk i takojnë kësaj fushe të ekspertëve. Edhe unë pajtohem me parafolësin për ta shtyrë këtë vendim dhe konkursi të rishpallet edhe njëherë dhe të zgjedhim me të vërtet ekspertë ashtu siç quhet ky komitet. Ne jemi kundër kësaj përbërje dhe kudër këtij vendimi.

Selami Xhemajli- së pari e përgëzoj punën e Komisionit për përzgjedhjen që e ka bërë, sepse ky është një ndër komitet konsultative prej të cilit priten rezultate, por shpresoj se Kuvendi do të marrë vendim për themelim edhe të komiteteve tjera e që do të punojnë në dobi të Komunës dhe qytetarëve. Nëse këta kandidatë i kanë plotësuar kushtet sipas konkursit, ne nuk mund të bëjmë shkelje dhe t'ia mohojmë të drejtën njerëzve për t'u zgjedhur në këtë komitet nëse i kanë plotësuar kriteret e parapara me konkurs. Unë në emër të grupit e përkrahi propozimin e komisionit për zgjedhje të këtij komiteti.

Avdyl Aliu -për mua është mendim ngushtë të thuhet se planifikimi hapësinor merret vetëm me arkitekturë dhe vetëm me arkitekt. Planifikimi hapësinor ka një kuptim më të gjerë dhe në këtë aspekt arsyetohet kjo përbërje. Ko përbërje nuk është 100% ajo që duhet të jetë, por është përbërje e mirë dhe është përbërje për ta filluar këtë punë. Këtë punë po e fillojmë në vitin 2015 dhe këtë vit po e themelojmë për të parën herë një komitet të tillë. Në këtë komitet janë dy arkitekt, është një eksperte për Mbrojtje të

mjedisit, por edhe me drejtim të gjeografisë, janë tre kandidatë e cila lëmi ka të bëjë edhe me planifikimin hapësinor dhe arkitekturë.

Unë e bëj një ftesë për ta votuar këtë Komitet dhe gjatë punës do ta shohim performancën e tyre, kurse gjatë ecjes së punës e ka mundësi për të bërë ndryshime.

Riad Rashiti- unë nuk mund të bindem se ka qenë dhe është e vetmja mundësi të mbetet kështu, sepse ka qenë mundësia tjetër dhe është edhe sot. Mirëpo nëse aprovohet dhe votohet sot nuk ekziston mundësia më vonë. Është mirë që të merren vendime pa inate dhe pa paragjykime. Nëse dëshironi për të punuar dhe krijuar kushte për hartimin e projekteve urbanistike për Komunë të Gjilanit, atëherë duhet menduar mirë dhe jo vetëm formalisht ta zgjedhim një komitet. Nëse lejoni që të formohet një komitet i ekspertëve e që në të vërtetë është jo i ekspertëve, mendoj se këtë po bëni me qëllim që të vazhdojë ky kaos i ndërtimeve pa leje në Gjilan !

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – normalisht se ka mangësi, por konkursi ka qenë i hapur dhe nuk e ka ndaluar askush as LDK-në as PDK-në dhe partitë e tjera për t'i inkurajuar kuadrot për të konkurruar në këtë komitet, prandaj mendoj se komisioni i ka kryer punët shumë mirë me kandidatët që janë paraqitur në konkurs.

Izmi Zeka- të më japin sqarime kryetari i Komisionit se çfarë lidhje ka Fakulteti i Edukimit me planifikimin hapësinor? Në këtë komitet ka mbetur vetëm një kandidat me fakultet të gjuhës shqipe pastaj të “plotësohet ashtu di duhet ky komision”. Ky komision ka qenë edhe më herët, por aty kanë qenë njerëz që kanë pasur përgatitje pikërisht që ka të bëjë me planifikim hapësinor.

Unë nuk i mohoj këta emra, sepse edhe këta janë ekspertë, por janë ekspertë të edukimit dhe jo të planifikimit hapësinor. Ju po thonë se e keni pushtetin dhe zgjidhni kandidatët nga partia e juaj, por për ju është më mirë që ta bëni punën ashtu si duhet. Çka kuptojnë kuadrot e Fakultetit të Edukimit në planifikim hapësinor, të ma tregojë një anëtarë i LDK-së? Nëse dëshirojmë për ta bërë vetëm një numër, atëherë edhe ne mund ta propozojmë një emër dhe ta zgjedhim këtë komitet.

Mirëpo ky është komitet i ekspertëve dhe e ka një emër të madh, prandaj vërtetë duhet të zgjedhim ekspertë. Gjilani ka ekspertë të dalluar dhe nuk duhet ekspertët lënë jashtë lojës! Ky propozim për këtë komitet është joprofesional, prandaj ka qenë deshtë ta anuloni konkursin. Unë për hir të qytetarëve po iu lus që rishkone edhe njëherë këtë propozim!

Bujar Nevzadi- unë po e pyes kryetarin e komisionit; sa kandidatë kanë konkurruar për këtë komitet ? Mandej kryesuesja e tha se ne nuk mund t' i detyrojmë njerëzit për të konkurruar, por nuk konkurrojnë njerëzit kur e dinë paraprakisht se kush do të zgjidhet!

Avdyl Aliu- është përgjegjësi të flitet kështu, sepse Kuvendi sipas përfaqësimit politik, Kuvendi e ka propozuar një vend në panel për PDK-në, por ai kandidat nuk ka marrë pjesë në intervistim të kandidatëve. Është heq dorë prej punës ku duhet dhënë, kurse sot flitet me tone të ashpra dhe epen vërejte të pavend. Së paku ai që ka qenë i propozuar në panel së paku nuk duhet të flasë.

Në konkurse kanë marrë pjesë 9 kandidatë, prej tyre 7 kanë marrë pjesë në intervistë dhe të gjithë dokumentacionin e kemi shqyrtuar, prej të cilëve 2 janë arkitekt, një për mbrojtje të mjedisit, një sociolog , të tjerët me Fakultet të Edukimit drejtimi i gjeografisë i cili drejtim ka shumë provime që kanë të bëjnë me planifikim hapësinor. Një prej tyre me drejtim të Gjeografisë Nexhmedin Bllaca me pasion punon në fushën e planifikimit dhe mendoj se për fillim është një komitet mjaft profesional, sepse trangu i këtij komiteti është mjaft i mirë. Unë kërkoj që ne ta votojmë këtë komision dhe ta fillojë punën.

Shukrie Rapuca- unë nuk po flas asgjë për këta emra, sepse absolutisht nuk ka asgjë kundër tyre, por vetë fakti që quhet Komitet i Ekspertëve i një fushe, duhet së paku ta ketë edhe një përvojë disavjeçare.

Nëse ky grup ekspertësh ashtu si ju e quani ka sjell dëshmi se kanë pasur përvojë në këtë fushë edhe nëse është me Fakultet të Edukimit me siguri që do ta votojmë edhe ne.
Ne dimë se fjalë e madhe është të thuhet dikush është “ekspert”.

Bujar Nevzadi- e kam një reagim, sepse u tha se 7 kanë konkurruar dhe 7 janë pranuar, prandaj ky fakt tregon se këta njerëz kanë qenë të porositur nga partia në pushtet për të konkurruar. Kjo është e vërtetë.

E dyta ka qenë deshtë një “CV” e këtyre ekspertëve, sepse aty ka njerëz që nuk ka punuar asnjë ditë. Edhe njëherë si kolegët e mi kërkoj që ky konkurs të anulohet dhe të shpallet konkursi tjetër. Në të kundërtën ju mund ta aprovoni, por Komuna dhe Gjilani nga ai komision nuk presin asgjë.

Ismet Hajdini- unë desha ta them se ky është komitet këshillëdhënës, prandaj nuk duhet ekzagjeruar gjërat, sepse nuk janë këta që do ta përfaqësojnë shtetin e Kosovës. Ky komitet nuk është organ ekzekutiv dhe jemi duke debatuar gjatë për një komitet konsultativ që nuk e ka ndonjë rëndësi të veçantë.

Riad Rashiti- mua po më habit fjala e Ismet Hajdinit, sepse vetë fjala ekspertë është fjalë e madhe. Unë jam ekonomistë dhe nuk do ta kisha guximin për të qenë anëtarë i këtij komisioni, sepse puna duhet kryer ashtu si duhet.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- propozimi i z. Zeka ishte që të shpallet edhe njëherë konkursi për zgjedhje të Komitetit të Ekspertëve, ju lus të deklaroheni se kush është për këtë propozim?

Për këtë propozim ishin 9 për, kundër shpalljes së konkursit ishin 14, anëtarë dhe pas këtij votimi nuk aprovohet propozimi i z. Zeka.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.4 e rendit të punës?

Aprovohet 2.4: Propozim vendimi për caktimin e përbërjes së Komitetit konsultativ të ekspertëve të planifikimit hapësinor, me 17 vota të anëtarëve të Kuvendit, 9 ishin kundër, kurse të tjerat abstenime.

2.5 Draft Rregullorja për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin fiskal 2016

Zijadin Maliqi- së pari kërkoj falje nga anëtarët e Kuvendit, sepse Rregullorja është lëshuar me një gabim me faj timin, sepse nuk kam kontrolluar me kohë e të cilin gabim e kam vërejtë pas dy-tri dite. Kanë qenë dy tabela të vitit të kaluar, ajo ekzistuese dhe ajo pas aprovimit të Kuvendit. Zyrtari i financave në vend se ta printojë listën pas mbajtjes së Kuvendit e ka bërë një gabim dhe e ka printuar atë të parën.

Rregullorja e këtij viti nuk asnjë ndryshim nga viti i kaluar dhe në çdo pikë është e ngjashme. Me atë zbritje që e kemi bërë vitin e kaluar te objektet e banimit për 15%, prandaj kërkoj falje, sepse është një lëshim i imi.

Avdyl Aliu- në mbështetje të Ligjit të LVV dhe në mbështetje të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme, Ligjit për financat e pushteti lokal dhe në bazë të statutit të Gjilanit nga ne sot kërkohet që ta miratojmë draft Rregulloren për tatimi në pronë për vitin fiskal 2016.

Riad Rashiti- më vjen mirë që në fund po del ajo që ne e kemi kundërshtuar si opozitë, rritjen e tatimit në pronë në krahasim me vitin e kaluar. Është mirë që jeni munduar për ta përmirësuar gabimin e juaj e që kisha dëshiruar të jetë i paqëllimshëm.

Mirëpo neve 10 ditë na ka ardhur materiali para kohës, ju pas dy-tri dite e keni vërejt gabimin dhe 7 ditë të tjera nuk e keni parë të arsyeshme që ta na informoni në adresat tona se në pikën 2.5 është bërë një

lëshim. Me këtë informatë çdo gjë do të ishte në rregull, por unë mendoj që ky arsyetim është i mirë për juve, por ne mendojmë se në asnjë mënyrë nuk ka qenë gabim teknik?

Po e them këtë se kjo rregullore ka qenë deshtë të kalojë në komitetin përkatës, ka kaluar në KPF etj. Ju po gaboni në shumë gjëra si te gomat etj, pastaj po arsyetoheni, por ky arsyetim po iu flenë mirë, por nuk është gabim, por është se e keni ditë shumë mirë se iu ka zvogëluar buxheti për 500 mijë € nga Qeveria e Kosovës dhe me këtë rritje për 17% është saktë ajo shumë që e kishte mbuluar minusin e grandeve të Qeverisë. Ne e mbështesim këtë rregullore me këtë përmirësim, kurse në atë formë si ka ardhur materiali ka qenë definitivisht një veprim skandaloz po të kishte ndodhur.

Selami Xhemajli-në emër të grupit të AAK-së, unë e jap mbështetje kësaj rregulloreje që rregullon tatimin në pronë, si një mënyrë e të hyrave vetanake në Komunë.

Unë besoj në sinqeritetin e drejtorit, por ajo çka është kryesore tatimi në pronë është sipas reformave që i kemi bërë vitin e kaluar dhe ndarja sipas zonave ka mbetur e njëjtë në përcaktimin e normës të tatimit në pronë për objektet e banimit. Tatimi në pronë është i njëjtë si vitin e kaluar, prandaj unë në emër të grupit i japim mbështetje kësaj rregulloreje.

Krenare Latifi- edhe ne si LVV këtë rregullore e kemi analizuar me shumë kujdes dhe për neve ka qenë e habitshme se si na ka ardhur ky material e që kur ta llogarisim në total na dilte 17.5% më shumë tatim në pronë. Unë kam pyetje për këtë rregullore, sepse kjo është në fuqi, pse duhet të vijë përsëri e njëjta?

Për çfarë arsyeje? Nëse është obligim ligjor të vijë çdo vit në shqyrtim pajtohem (përgjigja ishte se kjo rregullore duhet të aprovohet çdo vit, me përmirësime nëse ka, nëse nuk ka, atëherë aprovohet ashtu si është).

Arben Maliqi- unë nuk kam rol të avokatit, por po shihet se edhe kërkim- falja nuk ka kurrfarë vlere.

Unë po habitem, sepse ne grupi i LDK-së e kemi pasur takimin dhe drejtori e ka thënë se kjo rregullore nuk ndryshon aspak. Në këtë rast nuk ka të bëjë asgjë me ndryshime, por ka të bëjë me një ndryshim teknik. Mos t' i japim konatikon tjetër, sepse këtë nuk e meriton drejtori siç është Zijadin Maliqi, sepse këtu ka qenë vetëm një gabim teknik.

Zijadin Maliqi- unë shumë sinqerisht iu sqarova se është bërë një gabim teknik, por gabimin e pranova unë dhe unë kam gabuar, sepse para se të dërgohet në KPF edhe në Kuvend ka qenë deshtë ta kontrolloj. Besimi tek punëtorët, angazhimi rreth planifikimit të buxhetit, ka bërë që e kam bërë këtë lëshim. Ju e dini shumë mirë dhe mund t' i shihni edhe procesverbalet se edhe në qeverisjen e PDK-së unë kam kërkuar që të bëhet zbritja e bazës tatimore, sepse norma tatimore është e përcaktuar në nivel të Kosovës dhe është e njëjtë në të gjitha komunat. Unë vazhdimisht kam kërkuar që baza tatimore të zbritet dhe ajo është zbrit vitin e kaluar diku për 15% tek objektet banesore dhe sikur të kishim pasur mundësi edhe këtë vit e kishim zbritur, por nuk lejohet më tepër. Një vlerësim më real do të bëhet vetëm në nivel të Kosovës, sipas materialit ndërtimor, vjetërsisë së objektit etj. Aktualisht është kjo dhe unë e kam bërë një gabim teknik dhe nuk mbulohen me 17% ato mungesat e tjera që po i thotë z. Riadi dhe shikuar në mënyrë profesionale, rritja e tatimit në pronë ndikojnë negativisht në vjelje të të hyrave. Kjo ka ndodhur dhe gabimi është i imi, sepse nuk e kam kontrolluar me kohë dhe e kam vërejt me vonesë këtë lëshim.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.5?

Aprovohet pika 2.5: Draft Rregullorja për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin fiskal 2016, me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat janë abstenime.

2.6 - Raporti i Komisionit të aksionarëve për gjendjen në Ndërmarrjen Publike “Eko Higjiena”, Gjilan

Avdyl Aliu- me rastin e raportimit të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike “Eco –Higjiena” kemi pritur që të jetë prezent edhe kryesuesi i Komisionit të aksionarëve, z. Xhelal Jetishi, por ai nuk është i pranishëm deri më tash i cili në bazë të ligjit kryetari i Komisionit të aksionarëve duhet ta jep raportin. Pasi që nuk është kryetari i Komisionit, kërkoj që raporti të shtyhet për seancën radhës.

Në debat për këtë pikë morën pjesë, Fehmi Sylejmani, Riad Rashiti, Isa Agushi, bibish Ibishi dhe në fund kryesuesja kërkoj që së pari të votohet për ata kuvendar që kërkuan që të mos vazhdohet debati, por pati edhe debatues që kërkuan që të debatohet dhe epet raporti për punën e kësaj ndërmarrje.

Kryesuesja i propozoi dy variantet për aprovim , kurse Kuvendi, votoi kështu:

Për të dhënë raport ishin 3 anëtarë, kurse për ta shtyrë raportin ishin 18 anëtarë të Kuvendit.

Ibish Ibishi- në fillim të seancës këtu ishte përfaqësuesi i aksionarëve të cilin ne e kemi dërguar dhe tash është këtu dhe tash kur 60% të pikave të rendit të punës i kemi kaluar dhe tash të hidhet në votim të debatohet apo jo raporti, është një shkelje e rregullores së Kuvendit.

2.7 -Raporti i Komisionit të aksionarëve për gjendjen në Ndërmarrjen Publike “Stacioni i Autobusëve”, Gjiilan

Abdyl Aliu- Kryesues i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike “ Stacioni i Autobusëve” – Z, Abdyl Jerliu e dha raportin për këtë ndërmarrje e të cilin raport anëtarët e Kuvendit e kanë në material të seancës së Kuvendit.

Riad Rashiti- unë i kam disa pyetje për t’ia bërë kryesuesit të aksionarëve të kësaj ndërmarrje: së pari si raport është dukshëm më i mirë se sa raporti i një tjetër kompanie publike, sepse ka informacione më tepër në shumë aspekte. Ne e dimë vendimin e juaj që keni marrë për shkarkimin e Bordit që ka qenë në atë kompani dhe e keni dhënë një arsyetim i cili nuk qëndron ajo, sepse ju duhet ta jepni sqarimin, pse e keni shkarkuar atë Bord? A ka pasur bashkëpunim normal derisa është shkarkuar ai Bord? Sa takime i keni mbajtur së bashku dhe për cilat çështje keni diskutuar dhe si keni ardhur deri te konstatimi për ta shkarkuar këtë Bord.

E dyta keni deklaruar se e keni bërë emërimin e përkohshëm të një Bordi tjetër, por për këtë kam një pyetje se në cilin ligj jeni bazuar ju dhe keni emëruar një Bord të përkohshëm ? Unë deri më sot nuk e di asnjë rast në Kosovë se ka ndodhur emërimi i Bordit të përkohshëm! ? Ky për mua është veprim antiligjor, por nëse është ligjor kërkoj sqarim se në cilin ligj dhe cilin nen jeni bazuar kur keni emëruar Bord të përkohshëm? Mandej sa muaj iu duhet juve për ta shpall një konkurs dhe për ta zgjedh Bordin e ri?

Sa i përket anës financiare keni mjaft të dhëna, por duhet ta kemi edhe listën e operatorëve që i kanë borxh kësaj kompanie? Të na sillni informacione për shkëputje të kontratave. Në shumë çështje ka informacione të mjaftueshme, por te disa çështje të ndjeshme nuk keni dhënë informacione? !

Jehonë Hyseni- ky raport i kësaj kompanie është diskutuar shumë në mbledhjen e Komitetit për Zhvillim Ekonomik i cili edhe është miratuar nga të gjithë anëtarët e komiteti me vërejtje e dhëna nga këta anëtarë. Është konstatuar se kjo ndërmarrje me vite të tëra nuk është menaxhuar mirë dhe nuk ka qenë transparente, por kjo Ndërmarrje një kohë ka qenë edhe pa Bord udhëheqës.

Ky raport nga komiteti është aprovuar dhe rekomanduar për KPF me shpresë se Bordi i përkohshëm i cili është emëruar për këtë ndërmarrje publike të menaxhojë ndërmarrjen më mirë, të jetë më transparent, të krijojë kushte më të mira për udhëtarët dhe të ushtrojë kompetencat dhe përgjegjësitë e veta ashtu si e parasheh Ligji për ndërmarrjet publike.

Duhet të përgatitet plani i biznesit për vitin e ardhshëm kalendarik në pajtueshmëri me politikat zhvillimore të sektorit që i bën Ministria e Linjës dhe në përputhshmëri me Planin zhvillimor Komunal. Të përgatiten raportet vetore dhe 3 mujore në formë të informatës dhe t’ i dërgohen edhe kryetarit të

Komunës. Unë si kryesues e Komitetit të Zh. Ek. dhe në emër të kuvendarëve të LDK-së e përkrahim këtë raport dhe kërkojmë që të aprovohet në Kuvend.

Leonrë Bunjaku- u përmend shkarkimi i Bordit i kryesuese së Bordit të Stacionit të Autobusëve.

Si ka mundësi që me një kërkesë të një anëtarë për mosbashkëpunim apo moskomunikim dhe pa vërejtje paraprake të bëhet shkarkimi i kryesuese e cila nuk e nënshkroi shpërblimin për veten, për derisa Xhelal Shabani apo kryesuesi i Komitetit të Auditimit i ndërprehet mandati dhe në të njëjtën kohë ai sistemohet në “Eco –higjienë”. Pse dikush favorizohet dhe bën një nënshkrim të paautorizuar të lavdërohet dhe të ngritet në detyrë, kurse dikush që nuk ka pranuar që të shpërblehet materialisht të largohet nga Bordi?

Abdyl Jerliu- ishte një pyetje pse u shkarkua Bordi? Bordi është shkarkuar për shkak të mosfunksionimit dhe jo transparencës. Ne kemi marrë pjesë si monitorues në mbledhje të Bordit, por në atë Bord, nuk ka pasur marrëdhënie të shëndosha kolegjiale, nuk ka pasur komunikim në mes vete dhe ata më tepër janë ofenduar në mes vete se sa janë marrë me punë të ndërmarrjes.

Ky Bord fare nuk ka debatuar për pika të rendit të punës, sepse më tepër kanë pasur probleme personale dhe gjatë tërë kohës fillim e mbarim mbledhja nuk a dhënë asnjë rezultat.

Komisioni Komunal i Aksionarëve e ka cek shumë mirë në vendim se sipas cilit ligj është zgjedhur Bordi i përkohshëm, për të cilin rast pyeti z. Rashiti. Në vijim z. Jerliu e lexon ligjin në të cilin janë mbështetur për ta formuar një Bord të përkohshëm.

Sa i përket shkarkimit të kryesueses të cilën pyetje e bëri zonja Leonorë, është e vërtetë se zonja kryesuese nuk e ka nënshkruar një vendim, por sipas ligjit është e obliguar për ta nënshkruar edhe pse voton kundër një vendimi, sepse vendimi merret me shumicë të votave.

Edhe emërimi i Bordit të përkohshëm është bërë sipas ligjit e thash edhe më lartë dhe është bazuar në nenin 171 të Ligjit mbi shoqëri tregtare dhe ndërmarrjet publike. Afati i Bordit të përkohshëm është dy herë nga 3 muaj. Sa i përket borxheve, un do ta dërgoj listën në Sekretari të Kuvendit, kurse ajo do t’ia përcjell juve.

Leonorë Bunjaku- sipas cilit ligj dhe a ka pasuar të drejtë Xhelal Shabani të nënshkruajë atë vendim dhe të fitojë shpërblime materiale në shume prej 1 mijë e 200 € ?

Nuk pati debatues të tjerë kurse, kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.7 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.7 e rendit të punës: Raporti i Komisionit të aksionarëve për gjendjen në Ndërmarrjen Publike “Stacioni i Autobusëve”, Gjilan, me 15 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 6 ishin kundër

2.8 Propozim projekti për kompensimin e Komisionit për plotësimin e emërimit të rrugëve dhe numrimit të adresave për teritorin e Komunës së Gjilanit

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – është e ditur se ne në bazë të ulësve në Kuvend e kemi formuar një komision për emërtimin e rrugëve i cili Komision po e bën një punë jashtëzakonisht të madhe, por ky komision ka punë edhe më tutje. Në materialet e juaja e keni parë se është kërkuar një shumë e mjeteve për kompensim të këtij komisioni Unë i lus anëtarët e Kuvendit që ta përkrahin këtë Komision, e i cili komision ka kërkuar një shumë prej 30 mijë € e që i bie që secili anëtarë të paguhet për çdo muaj nga 200 (dyqind) €, kurse Komisioni i ka 15 anëtarë €.

Riad Rashiti- ne si Komision e përkrahim punën të cilën është duke e bërë ky Komision për emërtimin e rrugëve dhe lagjeve të qytetit dhe fshatrave, por gjithashtu e përkrahim edhe pagesën e këtij Komision për aq sa është propozuar. Mirëpo i kam disa pyetje: “a ka buxhet të planifikuar për këtë Komision dhe kur mund të paguhet kjo shumë?” 30 mijë € për paga dhe mëditje, nuk mjete të mjaftueshme në këtë kod dhe nuk ka mundësi të bëhet kjo pagesë?

Gjithashtu koha është planifikuar që për këtë aktivitet janë planifikuar 10 muaj e që më duket një kohë mjaft e gjatë edhe pse është punë voluminoze. 15 anëtarë, 3 mijë € në muaj, mendoj se është një shpenzim mjaft i madh, prandaj do të duhej të planifikohet ndryshe organizmi i takimeve nëpër vendbanime për të bashkëpunuar me Këshillat e fshatrave. Dhe në fund kam pyetje: “ a paguhen Këshillat e fshatrave për punën thelbësore që e bëjnë ata, apo ata nuk paguhen fare”?

Kjo pagesë duhet të bëhet në një OJQ “Agro-eco” në Gjilan, por arsyetimi që është dhënë për mua ai arsyetim është i papranueshëm. Për mua është shqetësuese se si mund Komuna, t’ ia ndaj 30 mijë €, një OJQ e cila i ka përfituar 200 mijë €, nga Komisioni Evropian?

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- këto 30 mijë €, fare nuk kanë të bëjnë me ato 200 mijë €, sepse ai është projekt i Komisionit Evropian për bashkëpunim ndërkufitar.

Sadri Arifi- në këtë rast është fjala për një Komision për emërtimin e rrugëve sipas sistemit të ri të adresave. Për pagesë të Komisionit është gjet një mënyrë e pagesës përmes “Agro-ecos” për ta zbatuar këtë projekt, sepse aty ka anëtarë të cilëve nuk mund t’ i bëhet pagesa në mënyra tjera, prandaj për ta ndihmuar këtë projekt iu lus që ta aprovoni, sepse ka anëtarë që 200 € i bën shpenzime, sepse duhet të udhëtojnë Gjilan- Prishtinë.

Selvete Shurdhani- sa i përket pagesës së anëtarëve të Komisionit, unë mendoj se Komuna e Gjilanit është prapa komunave tjera, sepse në komunat tjera veç kanë përfunduar këto punë. Mirëpo koha e punës së komisionit është mjaft e gjatë dhe mjaft e mundimshme, por edhe me përgjegjësi, prandaj 200 € në muaj për këtë Komision nuk është shumë e madhe, prandaj duhet të përkrahet ky propozim-vendim në mënyrë që të përfundojë ky projekt.

Riad Rashiti- unë më duket se u keqkuptova, sepse ndoshta dikush po mendon se unë e kundërshtova pagesën e Komisionit. Unë e thash se është kohë e gjatë që është menduar për të përfunduar ky projekt, sepse 15 anëtarë nga 200 € bëjnë 3 mijë € në muaj.

Në vendimin e këtij projekti thotë se për zbatimin e këtij projekti buxheti janë 230 mijë €, prandaj shqetësimi i im personal është se çka është shpenzuar me 200 mijë € të Komisionit Evropian për këtë projekt?

Avdyl Aliu- ashtu shkruan si po thotë z. Rashiti në rreshtin e fundit, por duhet lexuar edhe më lartë, sepse aty thotë një përshkrim i organizatës së huaj. OJQ “Agro-eco” i ka përshkruar edhe aktivitet të tjera të cilat duhet t’ i zbatojë, por një ndër këto është edhe ky projekt për Komunën e Gjilanit. Aty e ka një histori të projekteve të cilat i ka përfituar dhe është fakt që i ka 230 mijë dhe ka bashkëpunim ndërkufitar me Komunën e Çairit.

Izmi Zeka- z. Zeka e lexon në vendim qëllimin e projektit dhe në bazë të kësaj po shihet se kjo OJQ me këtë punë dhe këtë aktivitet paska përvojë. Mua po më intereson se kjo OJQ e ka bërë emërtimin e rrugëve, apo i ka kompensuar anëtarët e Komisionit, apo çka ka ndodhur?

Nëse kjo OJQ e ka bërë emërtimin e rrugëve, atëherë ne paskemi bërë punë të kotë. Dua vetëm një sqarim, pagesa a bëhet përmes kësaj OJQ apo si bëhet?

Zijadin Maliqi- unë po e sqaroj nga ana buxhetore. Ky është një projekt i Komunës dhe nuk ka mundësi që ky Komision të paguhet nga kodi për paga dhe mëditje. Për ta bërë pagesën e këtij projekti duhet të bashkëpunohet përmes një organizate që merret me këtë veprimtari. Pagesa e projektit për t’ i bërë është një Kod buxhetor: sinjalizimi, horizontal, vertikal dhe numerizimi i objekteve. Nga ky kod duhet të bëhet pagesa, nuk a mundësi nga kodi i pagave dhe mëditjeve të bëhet pagesa po e them edhe njëherë.

Renan Imami – dha sqarime edhe shefi i Njesisë së Kuvendit, por edhe unë jam anëtar i këtij Komisioni, sepse çdo parti politike e a përfaqësuesin e vetë, prandaj i lus anëtarët e Kuvendit që ta aprovojnë këtë propozim-vendim.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.8?

Aprovohet pika 2.8 e rendit të punës: Propozim projekti për kompensimin e Komisionit për plotësimin e emërimit të rrugëve dhe numrimit të adresave për teritorin e Komunës së Gjilanit, me 14 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime.

2.9 Raporti i Korrje shirjeve 2015

Ramiz Ramadani – përkitazi me këtë raport fjalën e mori drejtori, por të gjithë anëtarët e Kuvendit këtë raport e posedojnë në materialet e seancës.

Arijetë Rexhepi – ne raportin e kemi pasur së bashku me materialin e seancës, por unë i kam dy pyetje, por edhe një sugjerim: para se të diskutohet në KPF ky raport a është diskutuar edhe në Komitetin për Zhvillim Ekonomik ky raport? Sa është realizuar planifikimi i të mbjellave vjeshtore me grurë, elb dhe tërshërë? Si sugjerim ju thoni se në Komunën tonë ende dominojnë variaritet e grurit nga Novi Sadi, prandaj pse ju nuk kontribuoni që bujqit të furnizohen me variaritet që kanë potencial më të lartë biologjik?

Jehonë Hyseni- unë desha t'iu njoftoj në emër të Komitetit të Zhvillimit Ekonomik dhe Agro-kulturë se në mbledhjen e mbajtur më 2 gusht është diskutuar raporti i korrje-shirjeve dhe është aprovuar nga të gjithë anëtarët e Komitetit dhe është rekomanduar në KPF.

Shukrie Rapuca- unë jam e informuar mirë me këtë raport dhe me kohë i kam përcjell këto aktivitete dhe punë dhe mund të them se gjithçka është si tha drejtori, por një pyetje e kam për drejtorin; “karshi vlerave referuese të vlerave paraprake, sa kg. është rritur rendimenti i grurit për hektarë”? Rendimenti i tërshërës ishte i mirë, kurse i grurit jo i mirë dhe është shumë i ultë edhe pse kanë qenë kushtet atmosferike jo të volitshme këtë vit. Pse ka ndodhur kjo?

Jonuz Hasani- unë e kam fjalën tek cilësia e grurit, sepse ka pasur disa dilema se gjëja ka pasur grurë me cilësi jo të mirë për organizmin e njeriut, kurse si çështje të dytë e kam një pyetje se sa do të ketë nevojë për import të grurit për shkak të rendimentit më të ultë në Kosovë gjatë kësaj vere?

Ramiz Ramadani – sa i përket pyetjes së znj. Rexhepi u dha përgjigja se është raportuar me 2 shtator, kurse sa i përket realizimit të mbjelljeve vitin e kaluar ka qenë 2.500 hektarë, kurse këtë vit i kemi pasur 2.800 hektarë e që është maksimumi. Nuk pres rritje këtë vit, sepse nuk kemi sipërfaqe për t'iu zgjeruar më tepër, por ne duhet të mundohemi për ta rritur rendimentin.

Edhe unë pajtohem që të ndërrohet variariteti me këtë të Novi Sadit, por është vështirë, sepse në popull vështirë ndërrohet bindja. Variaritet të cilat ne mendojmë t'iu fusim në treg janë të certifikuara nga ana e Ministrisë, por edhe janë eksperimentuar se janë adaptabile për kushtet tona.

Sa i përket pyetjes së znj. Rapuca, vitin e kaluar e kemi pasur mesataren diku afër 4500- 4600 kg për hektarë e që ka qenë një mesatare shumë e mirë. Mirëpo i tërë angazhimi i jonë është për ta rritur prodhimin.

Sa i përket pyetjes së Jonuzit për cilësinë, unë mendoj se cilësia e grurit këtë vit ka qenë shumë e mirë dhe më e mirë se çdo vit tjetër.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.9 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.9 e rendit të punës: Raporti i Korrje shirjeve 2015, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në sallë.

2.10. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Gjilanit për vitin e përfunduar më 31.12.2014

Avdyl Aliu- Zyra e Auditorit të Përgjithshëm e ka si mision për të kontribuar në menaxhimin e mirë të financave publike. Duke e realizuar këtë auditim dhe pastaj duke dhënë vërejtje dhe rekomandime për të gjeturat e periudhës së caktuar, pretendohet që në periudhat e ardhshme të metat e gjetura nga auditimi. Qëllimi i këtij auditimi është që të ngritën performancat e menaxhimit financiar në të gjithë sektorët komunal dhe si rrjedhojë të qiten disa tulla në murin e quajtur besim i qytetarëve në shpenzim të parasë publike. Është në fakt i mirë që ka pasur një bashkëpunim të mirë mes Zyrës së Kryetarit dhe Zyrës së Auditorit gjatë këtij procesi të rëndësishëm.

Raporti del të jetë shumë më i mirë se në vitet e kaluara, por kjo nuk do të thotë se duhet të jemi të kënaqur dhe se kemi arrit atë që e kemi dëshiruar, mirëpo jemi në rrugë të mirë sa i përket shpenzimit të parasë publike. Është e pamundur të ketë auditim e mos të ketë vërejtje, por me rëndësi është që të ketë rënie për çdo vit dhe të ketë progres dhe neve na gëzon fakti se këtë vit ka progres, sepse kjo ndikon në rritje të besimit të qytetarëve.

Riad Rashiti- edhe ne si grup i anëtarëve të PDK-së e vlerësojmë një raport shumë të mirë që e ka bërë Auditori i Përgjithshëm, sepse e ka treguar gjendjen reale në Komunë për qeverisjen në Komunë dhe e përkrahim si raport të tillë. Mirëpo përmbajta e këtij raporti është mjaft shqetësuese!

Të gjitha ato vërejtje që i kemi dhënë se si opozitë që dy vite për qeverisjen dhe për shumë procedura dhe aktivitete që janë bërë në Komunë kemi gjykuar se janë në kundërshtim me ligjet e Republikës së Kosovës dhe ato sot i ka konstatuar ky raport.

U tha këtu se është raport më i mirë se vitet e kaluara, por dëshiro ta di se ku dhe pse është më i mirë?

Në këtë raport Auditori kërkon nga kryetari i Komunës shumë punë të cilat do t' i dalin atij për t' i implemetuar në këtë vit (nëse e ka guximin). Në seancën tonë edhe ne në seancën e kaluar e ngritëm çështjen e të gjeturave të Auditorit, por kryetari reagoi ashpër duke na thënë se bëjmë akuza të paqena dhe tha se është një daft-raport, por doli që është raport.

Ky është raport final të cilin e ngrit si shqetësim në seancën e kaluar, por e ngritim edhe sot.

Në këtë raport janë paraqitur shumë vërejtje serioze, të meta serioze për mënyrën se si po qeveriset në institucionet dhe si po shpenzohet paraja publike, pa kontroll dhe pa llogaridhënie institucionale.

Në këtë raport janë konstatuar shumë shkeleje ligjore të Rep. së Kosovës, dobësi të vazhdueshme në kontrollimin e menaxhmentit dhe të kontrollove financiare kryesore (për të cilat raste z. Rashiti e lexon një parashkrim të këtyre të metave). Ka konstatuar humbje financiare nga moszbatimi i legjislacionit për pasuritë komunale. Nivel të ulët të mbledhjes së të hyrave vetanake, kontrata të skaduara me shfrytëzuesit e pasurive komunale dhe jo efikasitet të vazhdueshëm organizativ dhe vlerë të dobët për praktikën e prokurimit. Nuk ka të hyra të duhura si tek të hyrat nga qiratë, inkasimi i borxheve të vjetra, por edhe ka dhënë vlerësim negativ sa i përket mos investimeve të grandeve nga ana e Komunës e cila thotë se ka pranuar grande nga donatorët e jashtëm në shumë prej 222 mijë €, por të cilat nuk janë shfrytëzuar tërësisht, sepse një grand nga KE që e arrinte shumë mbi 157 mijë € nuk është certifikuar me kohë gjatë viti 2014, por që janë bartur për t' u shfrytëzuar në vitin 2015. Një suficit i të hyrave vetanake prej 840 mijë €, ka mbetur për pa u bartur në vitin 2015. Auditori ka bërë edhe konstatime dhe rekomandime të cilat nuk janë implemetuar nga qeverisja komunale dhe ndër to është edhe regjistri i pasurive komunale i cili nuk është plotësisht i besueshëm. Ato më shqetësuese që janë në këtë raport është se janë bërë shkeljet ligjore të legjislacionit për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale dhe nuk ka pasur kontroll nga këto të hyra. (për këtë rast z. Rashiti e lexon një pasues nga raporti i Auditorit). Auditori ka kërkuar një auditim të këtij rasti dhe masat e nevojshme administrative ose ligjore që duhet të ndërmerren. Ne si PDK këto raste i kem dërguar edhe në Prokurori Themelore e cila i ka konsideruar si raste të mbyllura, sepse ka

thënë nuk ka të gjetura, kurse auditori këto i ka gjetur së bashku me ne. Kjo tregon se Prokuroria në Gjilan të cilën ne qe disa herë po e kritikojmë për neglizhencë dhe për jo profesionalizëm, për shërbim të politikës në Gjilan po i mbron këto shkelje në Gjilan të cilat i jep Auditori.

Vërejtje tjera ka edhe te prokurimi, sepse ndodh që për një aktivitet të ndodhin 6 procedura të tenderimit. Edhe për këtë rast z. Rashiti e lexon edhe një pasues nga raporti i Auditorit.

Edhe te subvencionet ka mungesë të menaxhimit të dobët dhe mungesë të raportimit financiar nga ata që i kanë përfituar këto subvencione e sidomos në Drejtori të Kulturës dhe Sportit.

Me një falë ky raport është shqetësues, sepse tregon se në Komunë të Gjilanit është kthyer anarkia dhe nuk respektohen ligjet dhe procedurat.

Arijetë Rexhepi- sa i përket raportit të Auditorit ne si opozitë jemi të shqetësuar, sepse në këtë raport iu kanë dhënë vërejtje Komunës së Gjilanit në të gjitha fushat si është dhënia në shfrytëzim e pasurisë komunale e cila është në kundërshtim me ligjin, objektet komunale të dhëna me qira nuk iu janë nënshtruar procedurave ligjore. Në vend të kësaj Komuna ka bërë kontrata të përkohshme me shfrytëzuesit me ç’ rast janë gjetur 35 kontrata të këtij lloji dhe për këtë arsyeje ndryshimi thelbësor i këtyre kontratave ka rezultuar me humbje financiare për vitin 2014 për Komunën 33 mijë e 600 €, kurse për periudhën 5 vjeçare humbja mund të jetë 168 mijë €.

Te sektori i Prokurimit për shkak të mos planifikimit të mirë dhe mospërputhjes së nevojave dhe planeve fillestare i kemi 120 procedura të prokurimit të cilat arrijnë vlerën në 5 milion e 590 mijë € shpenzime të kryera përmes prokurimit. Gjithashtu edhe mos planifikimi i mirë i kërkesave për blerje dhe procedura të prokurimit ka rezultuar me numër të lartë të prokurimit me kuotim çmimesh dhe shmangie të procedurave të hapura. Si pasojë e kësaj ekziston rreziku që mos të arrihet vlera për para, jo efikasitet organizativ dhe potencialisht ofertat më të shtrenjta.

Shqetësim tjetër nga ky auditim kemi se Komuna ka pranuar, grande nga dhuruesit e jashtëm në shumë prej 222 mijë € e të cilat nuk ka arritur t’ i shpenzojë me kohë. Ka pasur raste të konsiderueshme të tenderëve të incizuar dhe zhvilluar në të njëjtën kohë dhe me të njëjtit operatorë ekonomik, mandej dhënia e kontratave operatorëve ekonomik të papërgjegjshëm dhe në kundërshtim me legjislacionin publik dhe kërkesat e tenderëve mund të jenë me çmime më të larta. Vonesë në proces si rezultat i ankesave dhe humbje financiare, kurse te Sektori i Rinisë, Kulturës dhe Sportit thuhet se janë dhënë donacione, por mungon raporti dhe arsyetimi i shpenzimeve (epen subvencionet për pa e ditur pse)? Komuna nuk ka ndonjë strategji konkrete për mbledhjen e borxheve. Me nivelin e rekomandimeve nuk jemi të kënaqur, sepse këto rekomandime mbesin të përsëritura nga viti në vit. Në fund po e vërejmë se në Komunën e Gjilanit merren vendime jo ligjore, Komuna nuk është transparente dhe dëmtohet rëndë buxheti i Komunës.

Zijadin Maliqi-më duhet ta marrë fjalë, sepse me këtë punë jam marrë mjaft gjatë herë si i “akuzuar, herë si akuzues”. Unë e kam analizuar mirë këtë raport dhe me përgjegjësi po e them se që nga viti 2003 kur ka filluar auditmi i përgjithshëm e deri më sot raport më të mirë nuk ka pasur asnjëherë. Ka vërejtje edhe në këtë raport, por është vështirë të bëhet një raport dhe mos të ketë asnjë vërejtje. Për mua janë serioze tri rekomandime , rekomandimi i 4 e për të cilin rekomandim kryetari është duke punuar për eliminimin e kësaj të mete, mandej rekomandimi 5 dhe 6 e janë më serioze, të cilat në vijim i numëron z.Maliqi.

Pas fjalës së drejtorit për Buxhet dhe financa, nuk pati debatues të tjerë dhe me këtë përfundoi diskutimi përkitazi me Raportin e Auditimit.

Të ndryshme

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- në seancën e radhës kërkesa për gjendjen në asrim, do të jetë në seancën e radhës, por nën të ndryshme, kurse Informata për ndërtimet pa leje do të jetë pikë e veçantë.

Fehmi Sylejmani- çfarë po ndodh me parkingun e shkollave të mesme, të cilin parking po e shfrytëzon Viva. Çfarë dobie ka komuna nga ky shfrytëzim i këtij parkingu.

2. Në rrugën “Motrat Qiriazit”, në një tabelë shkruan, Kujdes: “ Rruga është duke u punuar”. Ndërkaq fare aty nuk akne filluar punimet dhe me çfarë të drejte i mashtroni dhe malltretoni qytetarët e pafajshëm me këso gënjeshtër. Pse këtu nuk kanë filluar punimet, derisa edhe tenderi tashmë është shpallur?

3. Çka ka bërë deri më tani Komuna për banorët e lagjes së Kumanovës, kërkesa e të cilëve është asfaltimi i rrugës, është një lagje e re, goxha e madhe dhe në rritje?

4. Rreth 40 shtëpi afër tregut të veturave janë pa kanalizim. Çfarë masa ka ndërmarrë deri më tani ekzekutivi dhe çka parasheh për t’iu dalë në ndihmë këtyre banorëve?

5. Arsimi në Komunën e Gjilanit është në gjendje kaotike. Pse po heshtin organet më të larta relevante në komunë?

6. Pse po prolongohen mjetet e zotuar për mbështetje klubeve sportive, të cilët kanë vështirësi në çdo fillim të stinorit?

7. Edhe këtë herë televizioni lokal Vali, pas drekës fare nuk qëndron në sallë, ku janë arsyet e mos prezencës së tyre, përkatësisht incizimeve?

Krenare Latifi- unë i kam parashtruar edhe më herët dy pyetje (me 3 gusht 2015), por po i përsërisë dhe vlejnjë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike: 1. të na njoftoni për kontratën në mes të Komunës së Gjilanit dhe Marketit “Wiva “ te Posta e Vogël?

Po ashtu të na njoftoni përkitazi me transportin urban, për të cilën pyetje kam marrë përgjigje se gjëja projekti është, por pritet zbatimi, atëherë kur të vendos kryetari i Komunës. Mirëpo qytetarët vazhdimisht pyesin se kur do të fillojë së zbatuari një projekt i tillë shumë i nevojshëm për ata?

Leonore Bunjaku- unë po e bëj të njëjtën pyetje për të satën herë, por derisa të realizohet, unë nuk do të ndalem. Në emër të mësimeve të Gjinnazit të Shkencave Natyrore edhe njëherë bëjmë kërkesë për rrënimin e ish objektit të Ekonomisë së Pyjeve i cili objekt me pamjen e tij të shëmtuar po e pengon mbarëvajtjen e mësimit në këtë Gjinnaz.

Sadullah Kadriu- unë shprehi një shqetësim i cili shpesh po përsëritet në Kuvend për Shoqatën e Hendikosit e cila tash është një gjendje jashtëzakonisht alarmante. Unë jam i informuar se kjo OJQ aktualisht nuk kanë rrymë në objektin ku punojnë dhe zhvillojnë aktivitete. Komuna i ka premtuar se do t’ia shlyej një borxh që e kanë, kurse Komuna ia ka lejuar një shumë prej 9 mijë € .

Që nga viti i ri nga qendra i shpëputen edhe kontratat punëtorëve dhe ju e dini se 1200 anëtarë që kanë qenë në përkujdesje të Hendikosit tani e tutje do të mbesin në mëshirën e askujt. I lus të gjithë që t’i dalin në ndihmë kësaj OJQ e cila ka bërë shumë për personat me aftësi të kufizuara.

Arijet Rexhepi- kam pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike: “ kur do të bëhet pastrimi te fusha që quhet “Dardania” e cila është e mbushur me mbeturina nga tregtarët e kafshëve për festën e Kurban Bajramit”?

Nexhat Hajrullahu- sa i përket pyetjes për Hendikosin, ju e dini se këtë vit për herë të parë është bërë një Memorandum me këtë OJQ dhe është një hap i mirë që edhe për shpenzimet e tyre kërkohet një llogari. Çështja e Hendikosit ka hyrë në sistem dhe ato shuma i kemi bartë pjesë-pjesë, kurse tash do ta bartim pjesën e fundit. Sa i përket borxhit, ai është trashëguar prej viteve të kaluara dhe është e vërtetë se me këtë rast është një problem i veçantë, por të cilin do të bëjmë përpjekje për ta zgjidhur.

Me këto debate dhe vendime, seanca i përfundoi punimet në ora 16.45 min.

Procesmbajtësi

Kryesuesja e Kuvendit

Sali HASANI

Valentin Bunjaku Rexhepi

